



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

BULETINI **STATISTIKOR**

VITI 2025

Tabela e Lëndës

- 1 KLSH përmes shifrave
- 2 Treguesit kryesorë të veprimtarisë audituese
- 3 Opinione/Mesazhe/Konkluzione auditimi
- 4 Niveli i Pranueshmërisë së Rekomandimeve
- 5 Menaxhimi dhe Zhvillimi i Burimeve Njerëzore
- 6 Programi i Transparencës dhe e Drejta për Informim
- 7 KLSH në media
- 8 Aneksë

AKRONIME

ISSAI - Standardet Ndërkombëtare të Auditimit

EUROSAI - Organizata Evropiane e Institucioneve Supreme të Auditimit

GAO - Zyra e Përgjegjshmërisë Qeveritare, SHBA

ECA - Gjykata Evropiane e Audituesve


CEF - Qendra e Ekselencës në Ekonomi e Lubjanës

SAI - Institucione Supreme të Auditimit

TIK - Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit

TI - Teknologjia e Informacionit

1. AKTIVITETI I KLSH PËRMES SHIFRAVE




** Për subjektet të cilat nuk kanë kthyer përgjigje mbi programet e masave për zbatimin e rekomandimeve të lëna, Në këtë fazë, për qëllime raportimi, këto masa janë konsideruar "pranuar".

2. TREGUESIT KRYESORË TË VEPRIMTARISË AUDITUESE

2.1 Auditimet sipas llojit

Kontrolli i Lartë i Shtetit, për vitin 2025, ka vijuar punën audituese në zbatim të programit të miratuar me vendimin nr. 218, datë 15.11.2024, të Kryetarit të KLSH-së, ka kryer dhe evaduar 190 misione auditimi nga 180 misione auditime të planifikuara, duke tejkaluar planin vjetor të auditimeve në masën 105% më shumë, në vlerësim të përputhshmërisë dhe rregullshmërisë financiare, performancës, IT dhe ndjekjes së statusit të zbatimit të rekomandimeve të lëna në periudha të mëparshme. Detajuar sipas llojit të auditimit, aktiviteti auditues paraqitet në tabelën në vijim:

Infografik nr. 1: Misionet e auditimit të evaduara, në numër dhe përqindje ndaj totalit



2.2 Institucionet ku janë kryer auditimet

Për vitin 2025, auditimet e kryera kanë përfshirë vlerësimin e aktivitetit në 271 subjekte, duke përfshirë nivele të ndryshme të qeverisjes si: institucione qendrore, ministri dhe agjenci (përfshirë drejtori qendrore dhe rajonale në varësi të tyre), njësi të vetëqeverisjes vendore, drejtori të përgjithshme të administrimit fiskal, si dhe shoqëri aksionere me kapital shtetëror në të cilat shteti zotëron mbi 50% të aksioneve, apo projekte me financim të huaj.

Infografik nr. 2: Kategoritë e institucioneve të audituara, në numër



2.3 Opinione/mesazhe/konkluzione sipas llojit të auditimit

Bazuar në programin e veprimtarisë audituese të KLSH-së për vitin 2025, Kontrolli i Lartë i Shtetit, për vitin 2025, ka përfunduar kryerjen e 190 misioneve të auditimit, duke konkluduar në 222 opinione/mesazhe/konkluzione auditimi, si më poshtë:

- **71** opinione për auditime përputhshmërie;
- **95** opinione financiar;
- **13** mesazhe në auditim performance;
- **43** konkluzione nga të cilat: **15** konkluzione mbi zbatimin e rekomandimeve, **5** në auditime përputhshmërie, **13** në auditim tematik, **10** në auditimet IT.

Infografik nr. 3: Opinionet/mesazhet/konkluzionet



Opinionet, mesazhet dhe konkluzionet e auditimit, të ndara sipas llojit të auditimit, paraqiten në tabelën më poshtë:

Tabela nr.1: Opinionet/mesazhet/konkluzionet sipas llojit të auditimit

Lloji i auditimit	Lloji i opinionit		Të tjera	Të tjera	Total
	I modifikuar	I pamodifikuar	Konkluzione	Mesazh	
Financiar	48	15	-	-	63
Të kombinuar nga të cilët:					
<i>Financiar</i>	25	7	-	-	32
<i>Përputhshmërie</i>	29	3	-	-	32
IT	-	-	10	-	10
Përputhshmërie	39	-	5	-	44
Performance	-	-	1	13	14
Tematik	-	-	12	-	12
Zbatim Rekomandimesh	-	-	15	-	15
Total	141	25	43	13	222

Mbështetur në standardet ndërkombëtare të auditimit (ISSAI 100), në bazë të gjetjeve të konkluduara mbi evidencat e auditimit, materialitetit dhe përhapjes, opinionet e dhënë mund të jenë “i modifikuar” ose “i pamodifikuar”. Në vijim:


Opinionet e pamodifikuar mund të jenë:

- të pakualifikuar, ose
- të pakualifikuar me theksim çështje


Opinionet e modifikuar mund të jenë:

- të kualifikuar,
- të kundërt, ose
- refuzues

Infografik nr. 4: Ndarja e opinionëve, mesazheve dhe konkluzioneve sipas llojit



2.4 Rekomandimet sipas natyrës



2.4.1 Masa organizative

Gjatë vitit 2025, për 190 auditimet e përfunduara, KLSH ka adresuar rekomandime për 3268 masa organizative dhe 29 propozime për ndryshime apo përmirësime ligjore në institucionet publike të audituara, me qëllim marrjen e masave për përmirësimin e situatës, të paraqitura më hollësisht në tabelën në vijim:

Tabela nr. 2: Masa organizative

Grupet e institucioneve	Nr. auditimesh	Masa organizative	Përmirësim ligjor
Institucione qendrore	46	879	3
Institucione të vetëqeverisjes vendore dhe njësi të tjera në nivel vendor	76	1403	2
Shoqëri publike dhe projekte me financim të huaj	37	607	2
Institucionet në të cilat janë kryer auditimet IT	13	110	2
Institucionet në të cilat janë kryer auditimet e Performancës	18	269	20
TOTAL	190	3268	29

2.4.2 Përmirësime ligjore

Gjatë vitit 2025, për 190 auditimet e përfunduara, KLSH ka adresuar rekomandime 29 propozime për ndryshime apo përmirësime ligjore në institucionet publike të audituara, me qëllim marrjen e masave për përmirësimin e situatës

Rekomandimet për përmirësime ligjore janë dhënë:

 **Në fushën e sigurisë kibernetike**, synohet hartimi i një metodologjie të qartë për identifikimin e operatorëve të infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit, duke përcaktuar rolin bashkëpërgjegjës të institucioneve përkatëse. Në këtë kuadër, parashikohet ndërmarrja e ndryshimeve ligjore dhe rregullatore për të saktësuar përgjegjësitë institucionale, veçanërisht në menaxhimin e të dhënave, me qëllim forcimin e mbrojtjes ndaj kërcënimeve kibernetike.

 **Në fushën e shëndetësisë**, rekomandohet të ndërmerren masa për përmirësimin e procedurave dhe të iniciohen ndryshimet përkatëse ligjore, me qëllim rritjen e efektivitetit dhe garantimin e zbatimit të ligjshmërisë në procesin e autorizimit të tregtimit të barnave.

 **Në fushën e arsimit dhe çështjeve sociale**, parashikohet përditësimi i kuadrit ligjor për të përfshirë dispozita specifike mbi mbikëqyrjen e ecurisë pas birësuese, duke përcaktuar qartë afatet dhe periodicitetin e monitorimit. Gjithashtu, synohet forcimi i shërbimit psiko-social në arsimin parauniversitar përmes hartimit të një strategjie të dedikuar, si dhe përmirësimi i legjislacionit dhe praktikave në trajtimin e të dënuarve.

 **Në fushën e administrimit të pronave**, synohet unifikimi i dispozitave ligjore dhe nënligjore përmes rishikimit të akteve ekzistuese dhe eliminimit të kundërshtive. Parashikohet ngritja e grupeve të punës për analizimin e problematikave që lidhen me saktësinë dhe cilësinë e raportimit të kontratave të qirasë dhe enfiteozës, si dhe ndërmarrja e nismave ligjore për përmirësimin e të drejtave dhe mekanizmave monitorues ndaj subjekteve që administrojnë pronën shtetërore. Gjithashtu, rekomandohen masa për përditësimin e akteve nënligjore në lidhje me afatet e ekzekutimit për prishjen e objekteve të kundërligjshme dhe përmirësimin e procesit të shpronësimeve, me qëllim unifikimin e praktikave, parandalimin e konflikteve ligjore dhe rritjen e efikasitetit në zbatimin e projekteve zhvillimore.

 **Në fushën e ekonomisë dhe shërbimit ndaj qytetarit**, synohet krijimi i një sistemi për identifikimin dhe kontrollin e subjekteve që operojnë në tregtinë online, bazuar në analizën e riskut. Parashikohet hartimi i një kuadri ligjor të plotë që përcakton qartë të drejtat dhe detyrimet e konsumatorëve dhe tregtarëve, si dhe zhvillimi i një platforme dixhitale që garanton procedura më transparente dhe të shpejta. Gjithashtu, vendosen standarde cilësie, mekanizma licencimi dhe auditimi për të rritur besimin në blerjet online, si dhe hartimi i një manuali të standardizuar për vlerësimin e riskut në trajtimin e dërgesave postare.

 **Në fushën e infrastrukturës**, rekomandohet klasifikimi i digave sipas nivelit të riskut dhe përcaktimi i distancave të sigurisë ndërmjet tyre dhe objekteve të tjera. Synohet gjithashtu eliminimi i mbivendosjeve mes rregulloreve për cilësinë e ujit të pijshëm dhe akteve të tjera që lidhen me ujërat sipërfaqësore, duke përfshirë rishikimin e rregullores përkatëse. Një element i rëndësishëm është qartësimi i përgjegjësisë për menaxhimin e cilësisë së ujërave dhe trajtimin e ujërave të ndotur, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të qytetarëve.

 **Në fushën e sigurisë dhe rendit publik**, theksohet nevoja për përcaktimin e qartë të tipologjive të incidenteve që duhet të raportohen nga oficerët e sigurisë, si dhe rishikimi i akteve ekzistuese për të mundësuar përfshirjen e tyre në strukturat disiplinore të institucioneve arsimore. Gjithashtu, propozohet krijimi i një mekanizmi të qartë financiar dhe nënligjor që siguron transferimin efektiv të një pjese të të ardhurave nga gjobat rrugore tek njësitë përkatëse të policisë. Në vijim, parashikohet hartimi i një vendimi për përcaktimin e kushteve, kriterëve të përdorimit dhe kontrollit të një fondi të posaçëm në funksion të veprimtarisë hetimore dhe informative.

Në figurën më poshtë gjeni të paraqitur numrin e rekomandimeve për përmirësime ligjore, sipas subjekteve/temës përkatëse të auditimit:

Infografik nr. 5: Përmirësime ligjore



Cilësia e ujërave në plazhe

3
propozime

Disponibiliteti i barnave në trajtimin e sëmundjeve tumorale

1
propozim

Drejtoria Vendore të Policisë
Shkodër

1
propozim

Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së
Territorit

1
propozim

Mbrojtja dhe Siguria e Digave

2
propozime

Roli dhe efektiviteti i oficerëve të sigurisë në
shkolla

2
propozime


Trajtimi, rehabilitimi dhe ri-integrimi i
personave të dënuar

3
propozime

2.4.2 Gjetje me efekte negative në të ardhura dhe shpenzime

Gjatë vitit 2025, janë dhënë 722 rekomandime mbi gjetje me efekte negative në buxhetin e shtetit, për total vlerën 26,210,795 mijë lekë, nga të cilat: dëmi ekonomik vlerësuar 1,593,093 mijë lekë, menaxhimi jo efektiv i fondeve në vlerën 24,617,703 mijë lekë.

Infografik nr. 6: Efektet negative financiare në buxhet sipas fushave kryesore (në '000 lekë)



Vlera e efekteve financiare me pasojë dëm ekonomik* në buxhetin e shtetit, është konstatuar 81% në fushën e të ardhurave dhe 19% në fushën e shpenzimeve.

Në fushën e shpenzimeve, peshën më të madhe (92%) e zënë shkeljet e konstatuara përgjatë procedurave të prokurimit dhe zbatimit të punimeve/kontratave në vlerën 274,873 mijë lekë (likuidime për punime të pakryera, mos llogaritje e kostove përfundimtare të shërbimit të projektimit, punime jo në përputhje me specifikimet teknike, etj). Problematikat e konstatuara nga auditimet lidhen jo vetëm me planifikim jo të drejtë të nevojave por edhe një proces të realizuar jo në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi. Mangësitë i referohen implementimit jo të saktë të kërkesave dhe detyrimeve ligjore nga entet publike që prokurojnë fondet përmes sistemit të prokurimit publik. Dëmi ekonomik në fushën e prokurimeve publike konstatohet si shkelje në: përgatitjen e dokumentacionit të tenderit, hartimin e specifikimeve teknike dhe kritereve të vlerësimit; llogaritjen e vlerës së kontratës; respektimin e kufijve monetar/ përzgjedhjen e procedurës së prokurimit publik; paraqitjen dhe pranimin e ofertave; hapjen dhe shqyrtimin e ofertave të paraqitura në konkurim; në njoftimin e fituesit, në procedurat e prokurimit me një ofertues, në lidhjen e kontratave dhe marrëdhëniet me nënkontraktorët, arkivimin e dosjeve për tenderat e zhvilluar; zbatimin e kontratave nga kontraktorët në përputhje me kushtet e përgjithshme etj.

Ndërsa në fushën e të ardhurave, peshën më të madhe në vlerën 1,243,611 mijë lekë (rreth 96% e totalit të të ardhurave) e zënë të ardhurat nga aktiviteti doganor, si pasojë e mos arkëtimit të detyrimeve doganore; pagesa detyrimesh doganore në import për të cilat nuk është vepruar në përputhje me kuadrin ligjor, vlerësime të gabuara të importeve dhe deklarimeve të artikujve, përjashtim i padrejtë nga pagimi i TVSH-së dhe trajtim i gabuar i shkeljeve doganore. Gjithashtu problematika janë evidentuar në fushë e “Të ardhurave të tjera” në vlerën 48,480 mijë lekë ose rreth 4%, si pasojë e mosaplikimeve të masës administrative me karakter financiar në formën e penalitetit, mos deklarime të sakta dhe të plota të transaksioneve.

*Vlera e detajuar e dëmit ekonomik, gjendet e pasqyruar në Aneksin nr. 4.3

Kontrolli i Lartë i Shtetit, gjatë vitit 2025, ka evidentuar shkelje të disiplinës financiare me ndikim negativ** në performancën e administrimit të të ardhurave, shpenzimeve dhe në përdorimin e fondeve publike në vlerën totale 24,617,703 mijë lekë nga të cilat:

- 19,667,208 mijë lekë në fushën e të ardhurave (ose rreth 80% e totalit) kryesisht në të ardhurat nga aktiviteti doganor në vlerën 6,326,080 mijë lekë (ose rreth 32% e totalit të të ardhurave) si pasojë e parregullsive të evidentuara në verifikimin e detyrimit për pagesën e taksës kombëtare të rentës minerare, mos aplikimin e gjobave për keqdeklarim ose shmangie të detyrimeve doganore sipas legjislacionit në fuqi. Problematika të tjera janë evidentuar dhe në zërin “Të ardhura të tjera” në vlerën totale 8,996,4433 mijë lekë (ose rreth 46% e totalit të të ardhurave) si pasojë e mos ndjekjes së procedurave për njohjen e të drejtave dhe detyrimeve të vendimeve të arbitrazhit, si pasojë e mos shlyerjes së detyrimeve përkatëse dhe detyrimeve të reja shtesë të subjekteve nënhuamarrëse, mos arkëtime detyrimesh të shkaktuara nga ndërhyrjet e paligjshme në sistemin e matjes së energjisë etj. Gjithashtu janë evidentuar problematika dhe në të ardhurat e qeverisjes lokale në vlerën 2,899,653 mijë lekë (ose rreth 15% e totalit të të ardhurave) për çështje që lidhen me detyrime për taksat dhe tarifatat vendore, mos tarifimit/përlllogaritjes së gabuar/mos aplikim të kamat vonesave për përdorimin e pronave të bashkisë nga subjektet private, si pasojë e mos vjeljes së taksës së ndikimit në infrastrukturë etj.
- 4,950,494 mijë lekë në fushën e shpenzimeve (ose rreth 20% e totalit) si rezultat i shkeljeve të disiplinës buxhetore lidhur me likuidimin e shpenzimeve në vlerën 3,070,451 mijë lekë (ose rreth 62% e totalit në fushën e shpenzimeve). Shkelje të konstatuara në praktikën e largimit nga puna të punonjësve në mënyrë të pa drejtë dhe të pargjyqësor, për shpenzime gjyqësore dhe përmbartimore, të lidhura me pagesat e kryera në zbatim të vendimeve gjyqësore për çështje të humbura nga institucionet, në vlerën 1,292,436 mijë lekë (ose rreth 26% e totalit në fushën e shpenzimeve). Gjithashtu janë evidentuar problematika edhe në procedurat e prokurimit dhe zbatimit të punimeve/kontratave në vlerën 587,606 mijë lekë.

Infografik nr. 7: Efektet negative financiare

Efekte negative	Dëm ekonomik	Menaxhim jo efektiv	Total
Në të Ardhura	1,294,305	19,667,208	20,961,513
Në Shpenzime	298,788	4,950,494	5,249,282
Total	1,593,093	24,617,703	26,210,795

**Vlera e detajuar e menaxhimit jo efektiv sipas subjekteve, gjendet e pasqyruar në Aneksin nr. 4.4

Tabela më poshtë paraqet vlerën e dëmit ekonomik, menaxhimit jo efektiv të fondeve, dhe mangësive në aktivitetin kontrollues tatimor me ndikim në performancën e administrimit të të ardhurave tatimore/doganore, të organizuar sipas fushave ku është konstatuar parregullsia:

Tabela 3: Efekte negative në buxhetin e shtetit, në mijë lekë

Efekte negative financiare	Dëm ekonomik	Menaxhim jo efektiv	Total
Shpenzime	298,788	4,950,494	5,249,282
Procedura prokurimi	3,846	276,422	280,269
Shpenzime për paga, shpërblime & sigurime shoqërore	1,269	1,292,436	1,293,704
Shpenzime operative	385	511,160	511,545
Zbatim punimesh	271,026	311,184	582,211
Shpenzime të tjera	22,262	2,559,291	2,581,553
Të ardhura	1,294,305	19,667,209	20,961,514
Të ardhura në urbanistikë	742	211,788	212,530
Të ardhura nga administrimi i pasurisë shtetërore dhe marrëdhëniet kontraktuale me palë të treta	1,472	1,060,780	1,062,252
Të ardhura nga aktiviteti doganor	1,243,611	6,326,080	7,569,691
Të ardhura nga aktiviteti tatimor	-	577,040	577,040
Të ardhura të paarkëtuara (taksa & tarifa) në qeverisjen lokale	-	2,495,088	2,495,088
Të ardhura të tjera	48,480	8,996,433	9,044,913
Total	1,593,093	24,617,703	26,210,796

2.5 Masa disiplinore dhe administrative


2.5.1 Masa disiplinore

Bazuar në Ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, KLSH, për të metat dhe shkeljet e konstatuara, ka adresuar tek subjektet e audituara 975 rekomandime për masa administrative dhe disiplinore, nga të cilat 59 masa administrative dhe 916 masa disiplinore.

Konkretisht, për shkeljet e konstatuara në bazë të ligjit të mësipërm, Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, neni 58 dhe Kodit të Punës, KLSH u ka kërkuar organeve respektive shqyrtimin dhe marrjen e 916 masave disiplinore nga të cilat:

- 582 masa disiplinore sipas Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, neni 58 (pasi për 89 masa, punonjësit kanë rezultuar të larguar nga puna).
- 197 masa disiplinore sipas Kodit të Punës dhe Kontratës Kolektive apo Individuale të Punës (pasi për 47 masa, punonjësit kanë rezultuar të larguar nga puna).


Infografik nr. 8: Masat disiplinore sipas ligjit për nëpunësin civil dhe sipas kodit të punës



2.5.2 Masa administrative

Bazuar në Ligjin Nr.154, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, KLSH, për të metat dhe shkeljet e konstatuara, ka adresuar tek subjektet e audituara 59 masa administrative. Konkretisht, për shkeljet e konstatuara, KLSH u ka kërkuar organeve respektive (APP, IMTV, institucionit përgjegjës sipas kuadrit ligjor përkatës) shqyrtimin dhe marrjen e 59 masave administrative, si në infografikun më poshtë:

Infografik nr. 9: Masat administrative sipas llojit



AKSESUESHMËRIA PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUAR



Kuadri ligjor dhe strategjik në Shqipëri njeh të drejtën për akses dhe jetë të pavarur të personave me aftësi të kufizuara (PAK), por në praktikë nuk janë krijuar ende kushte të përshtatshme për realizimin e kësaj të drejte. Auditimi tregoi se, zbatimi i masave të Planit Kombëtar për Personat me Aftësi të Kufizuar 2021 - 2025 është i pjesshëm dhe i fragmentuar. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkitë Shkodër, Durrës dhe Pogradec nuk kanë siguruar një bashkëpunim të qëndrueshëm dhe funksional në këtë drejtim. Situata paraqitet problematike në fushën e transportit rrugor publik dhe infrastrukturës. Bashkitë e audituara nuk kanë miratuar plane të posaçme për aksesueshmërinë, nuk kanë kryer monitorime sistematike të kushteve ekzistuese dhe nuk kanë zbatuar kriteret për aksesueshmëri në projektimin dhe inspektimin të ndërtimeve të reja. Kuadri ligjor aktual nuk përcakton nivelin minimal të aksesueshmërisë së garantuar në transportin rrugor publik. Për më tepër, legjislacioni kombëtar nuk është i përafëruar me standardet e Bashkimit Evropian në fushën e transportit të aksesueshëm. Në mungesë të ndërhyrjeve të strukturuar, mekanizmave funksionalë të bashkëpunimit dhe mbështetjes së qëndrueshme teknike e financiare, personat me aftësi të kufizuara vazhdojnë të përballen me barriera serioze në qasje dhe pjesëmarrje të barabartë në jetën publike, duke u penguar të jetojnë në mënyrë të pavarur dhe dinjitoze.



NDOTJA E LIQENIT ARTIFICIAL TË TIRANËS

Mbështetur në ISSAI 4000 “Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Përputhshmërisë”, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH-së dhe Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë audituam veprimtarinë e institucioneve, si Bashkia Tiranë dhe institucionet e varësisë dhe Agjencia Kombëtare e Mjedisit, në lidhje me ndotjen e shfaqur në Liqenin Artificial të Tiranës, duke krahasuar me kriteret e vlerësimit, përfshirë aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë veprimtaritë e tyre. Nga auditimi në terren, referuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion ka rezultuar se sistemi i menaxhimit, koordinimit institucional dhe infrastrukturës ekologjike në përgjithësi nuk ka funksionuar, duke e lënë hapësirën e LAT të pambrojtur ndaj ndotjes në mënyrë sistematike. Ne besojmë se dëshmitë e evidencës së auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë konkluzionet si vijojnë: Parku i Madh i Liqenit Artificial të Tiranës përfaqëson një aset të rëndësishëm natyror dhe social për qytetin e Tiranës. Për të siguruar që ky aset (PMLAT së bashku me basenin e liqenit) të ruhet, pastrohet dhe të zhvillohet në mënyrë të qëndrueshme për gjeneratat e ardhshme, nevojiten masa urgjente dhe një strategji afatgjatë.

Nga auditimi i KLSH-së ka rezultuar se:

- Bashkia Tiranë, e cila është në rolin e administtores së PMLAT, nuk ka hartuar një plan menaxhimi të Liqenit Artificial të Tiranës, për ndarjen e detyrave, bashkëpunimin dhe bashkëveprimin e institucioneve të qeverisjes qendrore dhe lokale, për të garantuar zhvillimin e qëndrueshëm të Liqenit artificial të Tiranës, për të verifikuar e ndaluar të gjithë shkarkimet e ujërave të përdorura urbane, industriale, etj., që mund të vijnë si rrjedhojë e aktivitetit brenda territorit të PMLAT ose të përzierjes së jashtëligjshme të ujërave të zeza me kanalet e ujërave të bardha/ të shiut që shkarkojnë në liqen; Liqeni Artificial i Tiranës nuk ka një sistem qarkullues uji, por furnizohet vetëm me prurjen natyrore (ujërat e shirave); Bashkia Tiranë dhe institucionet e varësisë (APR, UKT, DPN2) nuk disponojnë një hartë/ plan shtrirje të rrjetit/sistemit të kanaleve të ujërave të shiut, të cilat derdhen në liqen.
- Nga auditimi u konstatua se tombinat e këtyre kanaleve janë të dëmtuara dhe nëpërmjet tyre evidentohen shkarkime të ujërave të ndotura. Territori i PMLAT nuk mbulohet nga rrjeti i kanalizimit, rrjedhimisht subjektet që operojnë brenda territorit të PMLAT-së e zgjidhin individualisht largimin e ujërave të ndotura urbane (p.sh. nëpërmjet gropave septike). UKT dhe institucionet e tjera të varësisë së Bashkisë Tiranë nuk kanë informacion mbi mënyrën e operimit të këtyre subjekteve lidhur me largimin e ujërave të ndotura urbane; Brenda territorit të Liqenit të Tiranës bazuar në kontratat e lidhura me UKT operojnë 10 subjekte private. Ndërkohë sipas përgjigjeve të APR rezulton se operojnë 14 subjekte, pra ndërmjet institucioneve nuk ka një evidencë të saktë të numrit të subjekteve të cilat operojnë në zonën e PMLAT, gjithashtu nga verifikimet në terren i grupit të auditimit rezultoi se brenda PMLAT ka më shumë se 14 subjekte, të cilat, në mungesë të rrjetit të kanalizimeve brenda territorit të PMLAT, operojnë me zgjidhje individuale (si gropa septike), të cilat janë të pamonitoruara nga institucionet shtetërore; Asnjë nga institucionet e varësisë së Bashkisë Tiranë, përfshirë APR-në që administron PMLAT, nuk kanë informacion mbi vendndodhjen dhe gjendjen teknike të gropave septike.
- Në lidhje me ndotjen e shfaqur në Liqen nuk janë kryer asnjëherë analiza mikrobiologjike, por vetëm analiza fiziko-kimike; edhe pse nga strukturat shtetërore është evidentuar që në muajin tetor 2024 (pra rreth 6 muaj më parë) se në Liqenin Artificial të Tiranës ka shkarkime të ujërave të ndotura urbane të patrajuara, aktualisht përveç korrespondencave shkresore, nuk janë marrë masa konkrete për evidentimin e shkaqeve dhe shkaktarëve të ndotjes, marrjen e masave për ndërprerjen e menjëhershme të shkaqeve që shkaktojnë ndotje, si dhe përmirësimin e situatës mjedisore në liqenin artificial të Tiranës. Bashkëpunimi ndërinstitutional për zgjidhjen e problematikës nuk ka funksionuar, fakt i shprehur edhe nga vetë strukturat e APR gjatë auditimit.

Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit, si struktura e varësisë së Bashkisë Tiranë që menaxhon parkun, nuk ka një strukturë në përmbushje të funksioneve kontrolluese, inspektuese, evidentuese të veprimtarive të jashtëligjshme brenda territorit të PMLAT-së; APR-ja në asnjë rast nuk ka evidentuar problematika që mund të shkaktonin ndotje dhe nuk ka kërkuar bashkëpunim nga strukturat e qeverisjes qendrore për analizimin e cilësisë së ujit në liqenin e Tiranës, përpara shfaqjes në sipërfaqe të ndotjes dhe marrjes së vëmendjes mediatike të situatës. Për periudhën objekt auditimi 2021–2024, Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit ka shpenzuar 10,665,000 lekë për pastrimin e basenit të Liqenit Artificial të Tiranës.

Ky pastrim ka konsistuar vetëm në pastrim mekanik, pra heqje e plastikave nga sipërfaqja e liqenit, e bimësisë së tepërt, etj., por jo i lidhur me reduktimin/ eliminimin e elementëve që shkaktojnë ndotje në ujin e liqenit, të cilët janë në nivele të larta. Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit ka realizuar procedurën e blerjes së mallrave me vlerë nën 100,000 lekë, për 10,000 copë rasat peshku, duke cituar “...në funksion të përmirësimit të ekosistemit ujor...”. Për të iniciuar këtë blerje, në dokumentacionin e vënë në dispozicion nuk administrohej një relacion teknik nga specialistë të fushës.

Nga një verifikim rutinë i grupit të auditimit në datën 06.01.2025, rreth një muaj pas depozitimit të rasatit të peshkut në liqen (referuar PV të datës 04.12.2024), u konstatuan në brigjet e liqenit tufa peshqish të mbledhur në sipërfaqe, çka mund të jetë pasojë e mungesës së oksigjenit në trupin ujor të Liqenit Artificial të Tiranës.

AKM-ja nuk ka përmbushur detyrimin e monitorimit të treguesve të cilësisë së ujit në Liqenin Artificial të Tiranës, edhe pse ky stacion është i përfshirë në rrjetin e stacioneve të monitorimit, në Programet Kombëtare të Monitorimit të Mjedisit.



BLERJET ONLINE NË SHQIPËRI, TAKSAT DHE SHËRBIMI NDAJ QYTETARIT

Tregtia online në Shqipëri vijon të rritet, por mbetet ndjeshëm prapa vendeve të rajonit dhe Bashkimit Evropian në nivel përfshirjeje dhe formalizimi. Sipas raportit Balkan Barometer 2024, vetëm një përqindje e vogël e bizneseve shqiptare realizojnë më shumë se 5% të shitjeve online, duke e renditur vendin me nivelin më të ulët të shitjeve online në rajon. Auditimi evidentoi mungesën e politikave të qarta dhe të integruara për tregtinë online nga institucionet politikëbërëse, si në aspektin e rregullimit të veprimtarive dixhitale, ashtu edhe në rolin mbikëqyrës të tyre. Nga ana tjetër, institucionet ligjzbatuese, si ato qendrore ashtu edhe ato vendore, nuk kanë arritur të përmirësojnë procedurat e brendshme për të menaxhuar risqet e blerjeve online në mënyrë efektive. Kontrollat fiskale dhe doganore janë të fragmentuara dhe mungojnë tërësisht fushatat sensibilizuese për konsumatorët dhe shitësit online. Mungesa e një qasjeje të integruar dhe mungesa e koordinimit ndërinstitutional ka lënë hapësirë për informalitet, duke kufizuar zhvillimin e tregut dixhital.

Nga institucionet përgjegjëse kërkohet një angazhim konkret për të garantuar interesin publik dhe të drejtat themelore të qytetarëve në epokën digjitale.

Vetëm përmes një qasjeje të koordinuar ndërinstitutionale, përmirësimit të kuadrit ligjor, forcimit të transparencës dhe ndërtimit të besimit publik, mund të sigurohet që tregtia online të funksionojë si një mjedis i drejtë, i mbrojtur dhe i barabartë për të gjithë përdoruesit.

Ndërhyrjet nuk duhet të jenë opsionale, por prioritare për të mbrojtur besimin dhe sigurinë e qytetarëve në një ekonomi që po digjitalizohet me ritme të shpejta.



ROLI DHE EFEKTIVITETI I OFICERËVE TË SIGURISË NË SHKOLLA

Siguria në shkolla përgjatë periudhës shtator 2021 – dhjetor 2024, ka rezultuar një proces jo efektiv, si rezultat i mangësive të kuadrit rregullator, mos ushtrimit siç duhet i rolit të oficerëve të sigurisë, e mungesës së monitorimit të tyre, si dhe mos koordinimit të institucioneve pjesë e këtij procesi.

Kuadri rregullator nuk ka përcaktuar rregulla të qarta sa i përket, mbledhjes, përpunimit dhe analizimit të të dhënave mbi incidentet në shkolla.

Aktiviteti i ushtruar nga oficerët e sigurisë, nuk u përgjigjet nevojave të shkollës, sepse nuk përdoren “instrumente matës” për të njohur këto nevoja dhe nuk ushtrohen kontrole fizike të nxënësve ose mjediseve të shkollave. Raportimi zyrtar midis aktorëve, pjesë e këtij procesi, ka mangësi të theksuara duke rezultuar i pa saktë e i pa plotë. Mos mbulimi i të gjitha shkollave me oficerë sigurie ka cenuar gjithashtu sigurinë në shkolla.

Koordinimi dhe bashkëpunimi midis Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar, Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë, Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar dhe Akademisë së Sigurisë, nuk është në nivele të duhura. Oficerët e sigurisë në shkolla nuk monitorohen, as nga drejtuesit e IAP-ve dhe, as nga strukturat përkatëse të Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar, Drejtoritë Rajonale dhe Zyrtat Vendore të Arsimit Parauniversitar.



CILËSIA E UJËRAVE NË PLAZHE (për periudhën 2019 – 2023)

Procesi i menaxhimit të cilësisë së ujërave të larjes nuk ka qenë efektiv. Cilësia e ujërave të larjes (plazheve) në Shqipëri ka ardhur duke u përkeqësuar në vitet e fundit dhe në vitin 2023 Shqipëria ka pasur cilësinë më të keqe se çdo shtet tjetër në Evropë. Monitorimi me qëllim vlerësimin e saktë të cilësisë së ujërave të larjes nuk ka ndjekur udhëzimet e përcaktuara në aktet nënligjore të vendit tonë si dhe direktivës përkatëse evropiane. Informimi i qytetarëve dhe turistëve mbi cilësinë e keqe të ujërave të larjes (kur kanë rezultuar si të tilla) nuk ka ndodhur në asnjë rast ashtu si edhe ndalimi i përdorimit të këtyre plazheve. Bashkitë Fier, Lushnje, Rrogozhinë nuk kanë impiant trajtimi të ujërave të ndotura urbane e për rrjedhojë të gjitha ujërat e zeza që gjenerohen nga këto bashki përfundojnë të pa trajtuara në lumenj ose kanale të cilat më pas derdhen në det. Ndërsa bashkitë e tjera, edhe pse kanë impiante të trajtimit të ujërave të ndotura urbane, nuk kanë kapacitete të mjaftueshme për të trajtuar të gjitha ujërat e ndotura të gjeneruara në territorin e tyre.

Për pasojë një pjesë e konsiderueshme e tyre përsëri përfundon e pa trajtuar në det, duke ndikuar kështu në përkeqësimin e cilësisë së ujërave në plazhe. Planifikimi dhe investimet në sektorin e kanalizimeve dhe trajtimit të ujërave të ndotura urbane vuajnë mungesën e koordinimit të institucioneve përgjegjëse duke qenë se shpërndarja, priorizimi, përthithja e fondeve si dhe shkëmbimi i informacioneve nga projektet e zbatimit nuk bëhet siç duhet.

Task-Forca e ngritur për përmirësimin e infrastrukturës për trajtimin e ujërave të ndotura që shkarkohen pranë ose në ujëra larëse nuk ka arritur të përmbushë plotësisht detyrimet e përcaktuara në Aktin Normativ nr. 8, datë 28.12.2023. Megjithatë, pavarësisht situatës, inkurajohet ndjekja dhe zbatimi i rekomandimeve të lëna në këtë raport me qëllim përmirësimin e mangësive dhe dobësive të konstatuara.



MASAT E NDËRMARRA NGA INSTITUCIONET PËRGJEGJËSE PËR ELIMINIMIN E DERDHJES SË UJËRAVE TË PËRDORURA NË LUMIN E LANËS NË TIRANË

Institucionet përgjegjëse nuk kanë marrë masa efektive për përmirësimin e cilësisë së ujit në lumin Lana.

Raportet e Gjendjes në Mjedis të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit konstatojnë prej vitesh se statusi i cilësisë së ujit në këtë trup ujqor klasifikohet në gjendje shumë të ndotur, duke shfaqur përkeqësim edhe në fillim të rrjedhës në Lanabregas, përgjatë viteve të fundit.

Monitorimi i kryer nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit ka qenë i pjesshëm, duke mos monitoruar të gjithë stacionet e monitorimit dhe të gjithë treguesit, për të vlerësuar plotësisht cilësinë e ujit dhe statusin ekologjik të lumit Lana.

Nga ana tjetër, mungesa e ndërhyrjes nga Bashkia Tiranë dhe Ujësjellës Kanalizime Tiranë sh.a. në rrjetin e kanalizimeve, mospërfundimi i investimit për Impiantin e Trajtimit të Ujërave të Ndotura Kashar nga Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve, si dhe mungesa e ofrimit të zgjidhjeve alternative nga të gjithë këto institucione, ka sjellë që ujërat e ndotura urbane të pjesës më të madhe të qytetit të Tiranës të vijojnë të shkarkohen të patrajtuara, duke ndikuar negativisht në cilësinë e ujit të këtij trupi ujqor. Situata aktuale paraqet nevojën për angazhim të menjëhershëm të institucioneve të sipërpërmendura, në zbatimin e rekomandimeve të lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit në përfundim të këtij auditimit, për të garantuar përmirësimin e situatës.



NDIKIMI NË MJEDIS DHE SHËNDET I AKTIVITETIT TË SHFRYTËZIMIT TË NAFTËS DHE GAZIT NË ZONËN PATOS-MARINËZ

Mungesa e një kuadri të integruar rregullator, mungesa e stacioneve të monitorimit të treguesve të mjedisit, mungesa e inspektimeve dhe monitorimeve në mënyrë periodike, ka krijuar boshllëqe serioze në kontrollin dhe parandalimin e ndotjes mjedisore si dhe në identifikimin e risqeve në shëndetin publik.

Gjithashtu, është vërejtur një mungesë koordinimi ndërinstitucional dhe jo transparent në publikimin e të dhënave, çka ka kufizuar aftësinë për të reaguar në kohë dhe në mënyrë të përshtatshme ndaj problematikave të konstatuara në zonat e prekura. Në aspektin shëndetësor, mungesa e të dhënave të detajuara dhe studimeve të thelluara mbi impaktin shëndetësor të ndotjes në komunitetin që jeton në këtë zonë, nuk ka mundësuar vlerësimin e rreziqeve dhe planifikimin e masave për mbrojtjen e shëndetit publik.

Në nivel vendor, investimet e kryera për riaftësimin dhe rehabilitimin mjedisor, kanë qenë minimale dhe të pamjaftueshme në përmirësimin e cilësisë së mjedisit dhe shëndetit në këtë zonë.

Masat e marra nga institucionet përgjegjëse për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit në zonën Patos-Marinëz nuk kanë qenë të mjaftueshme.




CILËSIA DHE CERTIFIKIMI I UJIT TË PIJSHËM QË HIDHET NË TREG PËR QYTETARIN

Sistemi i ngritur nuk ka arritur të garantojë qytetarin për cilësinë e ujit të pijshëm të ambalazhuar që hidhet në treg.

Megjithëse konsumi i këtij produkti ka pësuar rritje të vazhdueshme çdo vit, institucionet përgjegjëse nuk kanë arritur të përmbushin plotësisht detyrimet e tyre sa i përket kontrollit, monitorimit e analizimit të tij. Ndryshimet e kompetencave në strukturat shtetërore, kanë krijuar paqartësi në rolet dhe përgjegjësitë e tyre dhe kanë ndikuar në funksionimin e fragmentuar të sistemit.

Kuadri ligjor e rregullator paraqitet i pa harmonizuar dhe në disa raste kontradiktor, nuk mundëson konkurrencë mes projekteve për përdorimin e burimit ujor dhe ka kritere të dobëta për dhënien e lejeve dhe licencave.

Nga ana tjetër, mangësitë e institucioneve në drejtim të analizimeve laboratorike, bashkëveprimeve ndërinstitucionale si dhe informimit të publikut, nuk kanë garantuar cilësinë e ujit të ambalazhuar dhe sigurinë e nevojshme për qytetarin.




PLANET GJITHËPËRFSHIRËSE TË QEVERISË DHE ASPEKTET BUXHETORE PËR NJË POPULLSI NË MOSHIM (për periudhën 2020 – 2025)

Shqipëria nuk ka një plan gjithëpërfshirës dhe ndërsektorial që trajton fenomenin e moshimit të popullsisë. Ky fenomen adresohet në strategji apo plane sektoriale të cilat në vetvete nuk ofrojnë një mbështetje të plotë, të koordinuar dhe gjithëpërfshirëse për çështjet e moshimit të popullsisë.

Politikat sektoriale të ndërmarra deri më tani nga institucionet përgjegjëse në tërësinë e tyre, nuk kanë sjellë ndikim në përmirësimin e treguesve, pasi vendi ynë vijon të ketë rënie të lindshmërisë me afërsisht 72% nga viti 1990 në vitin 2024, bilanc migrator negativ me migrim neto nga -15,030 persona në vitin 2018, në -32,497 në vitin 2022, si dhe rritje të moshës mediane nga 32.6 vjeç në vitin 2011 në 44.3 vjeç në vitin 2025.

Duke iu referuar treguesve të analizuar është e nevojshme që të hartohen dhe të zbatohen politika të drejtpërdrejta në perspektivë afatgjatë, duke pranuar se ndryshimet në politikat e punësimit, lindshmërisë, migracionit, mbrojtjes sociale dhe zhvillimit ekonomik duhen dekada që të kenë një efekt të qëndrueshëm në shoqëri.



MBROJTJA DHE SIGURIA E DIGAVE (për periudhën 2021 – 2024)

Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Bashkitë Tiranë e Berat si dhe institucionet e tjera shtetërore përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe kontrollin e digave nuk kanë vlerësuar gjendjen e të gjitha digave në vendin tonë dhe nuk kanë marrë masat e duhura për përmirësimin e gjendjes së tyre.

Kuadri ligjor e rregullator nuk garanton një mbikëqyrje të plotë për të gjitha digat duke lënë jashtë vëmendjes digat e vogla. Objekt i veprimtarisë së Komitetit Kombëtar të Digave të Mëdha (KKDM) kanë qenë kryesisht digat e mëdha (rreth 350) ndërkohë që legjislacioni nuk i përjashton digat e vogla (rreth 300) nga fushëveprimi i tij. Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha, Sekretariati Kombëtar i Digave të Mëdha, Këshilli Teknik i Përhershëm i Digave dhe Inspektorati Teknik i Digave nëpërmjet veprimtarisë së tyre, nuk kanë garantuar mbulim me kontrole efektive të të gjitha digave në vendin tonë. Kontrolli, monitorimi dhe raportimi mbi gjendjen dhe sigurinë e digave vuan mungesën e ngritjes dhe funksionimit të të gjitha strukturave mbikëqyrëse, sistemeve të monitorimit dhe raportimit jo të plotë e të qartë.

Edhe pse janë kryer disa investime rehabilitues në 43 diga të ndryshme, ka munguar vëmendja institucionale dhe investime të qëndrueshme për përmirësimin e sigurisë së digave. Bashkia Tiranë dhe Berat nuk kanë pasur qasje pro aktive në gjurmimin dhe përthithjen e fondeve të ndryshme për të realizuar projekte rehabilituese në digat që kanë në administrim.



TRAJTIMI, REHABILITIMI DHE RI-INTEGRIMI I PERSONAVE TË DËNUAR

Sistemi penitenciar në Shqipëri nuk garanton ende kushte dhe trajtim të plotë rehabilitimi dhe riintegrimi për personat e dënuar, kjo në mospërputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare. Masat e programuara për përdorimin e burimeve financiare nuk janë orientuar dhe ndërlidhur drejt arritjes së objektivave specifike për financime të qëndrueshme në objektet e vuajtjes së dënimit. Bashkëpunimi ndërinstitutional ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë, Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, Shërbimit të Provës, AKPA-së, Ministrisë së Arsimit, pushtetit vendor dhe operatorëve ekonomikë është i pjesshëm dhe shpesh formal, me marrëveshje që nuk zbatohen plotësisht dhe mekanizma referimi që nuk japin rezultate dhe nuk ka shërbyer plotësisht për kthimin e ish të dënuarve pranë familjeve dhe ri integrimin e tyre në shoqëri.

Sistemi i burgjeve funksionon kryesisht si strukturë ruajtjeje dhe jo si mekanizëm i plotë rehabilitimi e riintegrimi, duke rritur rrezikun e recidivizmit dhe duke mos përmbushur pritshmëritë ligjore. Investimet e kryera dhe menaxhimi i shërbimeve mbështetëse në përmirësimin e kushteve nuk e kanë arritur qëllimin e tyre në kryerjen e një procesi profesional, të drejtë e efektiv në rehabilitimin dhe riintegrimin e të dënuarve pas lirit. Dobësitë në planifikimin e investimeve, menaxhimin financiar, dokumentimin, monitorimin dhe auditimin e brendshëm kufizojnë më tej efikasitetin e sistemit.

Përqindja shumë e lartë e të paraburgosurve dhe mbipopullimi në disa Institucione Ekzekutimi të Vendimeve Penale (IEVP) krijojnë problematika në menaxhimin e paraburgimit dhe në përdorimin e masave alternative ndaj burgimit. Infrastruktura është e amortizuar, me raste ekstreme si në IEVP-të Rrogozhinë e Lushnjë, ndërkohë që investimet kapitale janë fokusuar kryesisht në siguri dhe transport, jo në përmirësimin e kushteve të qëndrimit, arsimit, formimit profesional dhe aktiviteteve rekreative. Programet rehabilituese—arsim, formim profesional, punësim, trajtim psiko—social dhe përgatitje prag-lirimi mbeten me shtrirje të kufizuara, cilësi të ulët dhe nuk lidhen mjaftueshëm me nevojat reale të të dënuarve dhe tregut të punës, si brenda ashtu edhe pas lirit.




KUJDESI KOMUNITAR PËR TË MOSHUARIT DHE DECENTRALIZIMI I SHËRBIMIT (për periudhën 01.01.2020 – 31.12.2024)

Shërbimi i kujdesit komunitar për të moshuarit, në kuadër të decentralizimit të shërbimeve sociale, paraqet sfida të rëndësishme në nivel vendor. Megjithatë përgjegjësitë janë transferuar te bashkitë, zbatimi praktik shoqërohet me mangësi në organizim, planifikim, financim dhe mbështetje profesionale, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë dhe shtrirjen e shërbimeve.

Mungesa e strukturave funksionale për identifikimin dhe vlerësimin e nevojave, e të dhënave të standardizuara, si dhe varësia e lartë nga financimi qendror kanë kufizuar aftësinë e bashkive për të ndërtuar shërbime të qëndrueshme dhe të barabarta në të gjithë territorin.

Si pasojë, decentralizimi nuk ka arritur ende të përkthehet plotësisht në shërbime të aksesueshme, të planifikuara mbi nevoja reale dhe të ofruara në mënyrë të njëtrajtshme për të gjithë të moshuarit në nevojë.



ROLI DHE PËRGJEGJËSITË PËR MONITORIMIN E MIRËQENIES SË FËMIJËVE TË BIRËSUAR (për periudhën 2020 – 2025)

Mbështetur në ISSAI 4000 “Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Përputhshmërisë”, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH-së dhe Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, audituam veprimtarinë e Komitetit Shqiptar të Birësimeve në lidhje rolin dhe përgjegjësitë për monitorimin e mirëqenies së fëmijëve të birësuar.

Referuar evidencave të auditimit dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion ka rezultuar se sistemi i monitorimit pas birësues, si një garanci thelbësore për mbrojtjen e interesit më të lartë të fëmijës pas finalizimit të birësimit, nuk funksionon në mënyrë të plotë, të qëndrueshme dhe të besueshme, për shkak të dobësive të kombinuara në kuadrin ligjor dhe rregullator, organizimin institucional, zbatimin praktik dhe menaxhimin e dokumentacionit.

Ne besojmë se dëshmitë e evidencës së auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë konkluzionet si vijojnë:



U evidentua një boshllëk i rëndësishëm ligjor, pasi Ligji nr. 9695, datë 19.03.2007 “Për procedurat e birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimit”, i ndryshuar, nuk parashikon kohëzgjatjen e periudhës së monitorimit pas birësues, organin kompetent që duhet ta përcaktojë atë apo aktin nënligjor përkatës. Si pasojë, periudha 2-vjeçare e monitorimit është përcaktuar ndër vite vetëm në rregulloret e brendshme të KSHB-së, të cilat janë akte administrative të brendshme dhe lehtësisht të ndryshueshme. Kjo mënyrë rregullimi nuk siguron standardin e nevojshëm të stabilitetit juridik për një proces që lidhet drejtpërdrejt me të drejtat dhe mirëqenien e fëmijës, duke krijuar risk që karakteristikat e monitorimit (kohëzgjatja, periodiciteti, standardet e vizitave dhe raportimit) të mos kenë garancinë më të lartë ligjore.



Rezultoi se organizimi aktual i KSHB-së nuk garanton respektimin e parimit të paanshmërisë dhe të ndarjes së funksioneve, pasi të njëjtat struktura që kryejnë vlerësimin e aplikantëve, japin përshtatshmërinë, pëlqimin dhe finalizojnë hallkat e procesit birësues, janë gjithashtu përgjegjëse për monitorimin pas birësues. Kjo krijon konflikt potencial funksional, cenon objektivitetin e procesit të monitorimit dhe dobëson rolin e tij si “garancia e fundit” për të vlerësuar nëse birësimi është realisht i suksesshëm dhe nëse kërkohet ndërhyrje nga institucionet përgjegjëse.



U konstatuan mungesa në zbatimin e detyrimeve për monitorim, veçanërisht në rastet e birësimeve “me pëlqim”. Megjithëse ligji nuk e trajton këtë kategori si përjashtim dhe detyrimi për verifikimin e ecurisë pas birësuese shtrihet për të gjitha birësimet, në praktikë KSHB nuk ka kryer monitorim për 21 birësime vendase me pëlqim, duke interpretuar gabimisht se vullneti i palëve për finalizimin e birësimit përbën garanci të mjaftueshme për ecurinë pozitive. Kjo praktikë e dobëson funksionin mbrojtës të monitorimit dhe krijon risk të konsiderueshëm që problematika të mundshme të mos identifikohen dhe adresohen në kohë.



U evidentuan mangësi të theksuara në standardizimin dhe përshtatshmërinë e monitorimit në rrethana specifike, si ndryshimi i vendbanimit dhe shpërngulja jashtë vendit. Në dy raste konkrete, familjet birësuese janë transferuar për të jetuar përfundimisht jashtë Shqipërisë dhe, megjithëse ligji nuk e ndalon ndryshimin e vendbanimit, marrëveshjet me familjet birësuese nuk kanë parashikime të qarta për format alternative të monitorimit në këto raste. Si pasojë, nuk është kryer asnjë vizitë monitoruese në familje dhe KSHB nuk ka mundur të verifikojë fizikisht ecurinë pas birësuese, duke krijuar boshllëqe kontrolli në fazën më kritike të procesit.



Nga auditimi i 62 dosjeve të birësimeve vendase (2020 - 2025) rezultuan vonesa sistematike, mosrespektim i periodicitetit 6-mujor, mungesa të raporteve, mangësi në dokumentimin mbështetës dhe praktika monitorimi jo të mjaftueshme (takime vetëm në ambientet e KSHB-së ose në mënyrë virtuale, pa verifikim të drejtpërdrejtë në familje). Gjithashtu, u evidentua mungesa e bashkëpunimit ndërinstytucional në nivel vendor për sigurimin e informacionit plotësues dhe të pavarur (shërbime sociale, arsimore, shëndetësore), duke e kufizuar monitorimin kryesisht në informacionin e ofruar nga vetë familjet birësuese. Këto dobësi krijojnë periudha të gjata pa informacion të verifikuar për mirëqenien e fëmijës, dobësojnë funksionin parandalues të monitorimit dhe rrisin rrezikun që problematika të ndjeshme të mos adresohen në kohë.



Për birësimet ndërvendase u evidentuan dobësi serioze në ndjekjen dhe mbikëqyrjen e aktorëve të jashtëm (autoritetet qendrore të vendeve pritëse dhe agjencitë ndërmjetësuese). Në raste konkrete, KSHB nuk ka kërkuar për vite me radhë informacion monitorimi nga autoritetet përgjegjëse (p.sh. për dy raste të birësimeve në Greqi), si dhe nuk ka mbikëqyrur në mënyrë efektive agjencitë ndërmjetësuese për respektimin e afateve dhe dorëzimin e rregullt të raporteve pas birësuese (17 nga 27 dosje me vonesa/mosdorëzime të rregullta). Për më tepër, janë konstatuar raste ku KSHB ka pranuar raporte monitorimi të kryera nga agjenci të tjera të pa licencuara nga shteti shqiptar, duke cenuar kontrollin, besueshmërinë dhe ligjshmërinë e procesit.



U evidentuan dobësi në kontrollin e brendshëm dhe në ushtrimin e rolit verifikues të Këshillit Drejtues të KSHB-së, përfshirë mos verifikimin e vlefshmërisë së dokumentacionit në raste konkrete, si dhe mos verifikimin në asnjë rast të përputhshmërisë së legjislacionit shqiptar me legjislacionin e vendit pritës për birësimet ndërvendase. Kjo dobësi merr rëndësi të veçantë në kontekstin e rasteve ku birësimi rezulton i revokueshëm në vendin pritës (p.sh. në SHBA), duke cenuar parimin e parevokueshmërisë së birësimit të sanksionuar nga legjislacioni shqiptar dhe duke rritur rrezikun e dështimit të birësimit dhe pasojave të rënda për fëmijën.



U konstatuan mangësi të theksuara në ruajtjen fizike, arkivimin, plotësinë dhe integritetin e dosjeve, si dhe në kushtet e ambientit të Arkivë-Protokollit, në kundërshtim me ligjin për arkivat dhe normat tekniko-profesionale. Këto mangësi, në një institucion ku veprimtaria mbështetet pothuajse tërësisht në dokumentacion shkresor, rrisin ndjeshëm riskun për humbje/dëmtim të dokumentacionit, vështirësi në gjurmueshmëri, transparencë dhe përgjegjshmëri, si dhe dobësojnë kapacitetin e institucionit për të garantuar prova të plota e të besueshme për vendimmarrjen dhe monitorimin.

Në përfundim, KLSH vlerëson se KSHB nuk e garanton në mënyrë të mjaftueshme dhe të qëndrueshme funksionin mbrojtës të monitorimit pas birësues dhe nuk respekton plotësisht kërkesat ligjore/rregullatore për monitorimin, mbikëqyrjen, kontrollin e brendshëm dhe administrimin e dokumentacionit. Këto dobësi e ekspozojnë procesin e birësimit ndaj risqeve të larta të mosidentifikimit në kohë të problematikave që prekin mirëqenien e fëmijës, të cenimit të interesit më të lartë të tij, si dhe të dobësimit të besueshmërisë dhe integritetit të sistemit të birësimit në tërësi.

3.2 KONKLuzionet në Auditimet IT



Qendra e Arsimit Bashkia Lushnje

Mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit përkatësisht në, ISSAI 100, ISSAI 5300, ISSAI 5310 si dhe nenet 3 dhe 14 të ligjit 154, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH”, vlerësojmë se Qendra Arsimore pranë Bashkisë Lushnje nuk ka zhvilluar apo parashikuar sisteme dhe fonde për Teknologjinë e informacionit në buxhetet e viteve 2023-2024, në kundërshtim me kërkesat e nenit 37 të Rregullores së Brendshme nr.36 ,datë 06.04.2021 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Bashkisë Lushnje”.

Gjithashtu, infrastruktura ekzistuese rezultoi e amortizuar dhe joefikase, ku mungon siguri bazë si, firewall dhe switch të menaxhueshëm; pajisjet kompjuterike janë të vjetra dhe përdorin sisteme operative të pasigurta, si dhe mungesë zbatimi të procedurave për sistemet e monitorimit (kamera) në çerdhe dhe kopshte.

Për këto arsye, është e domosdoshme dhe urgjente që të kryhet një studim i detajuar i nevojave për infrastrukturën IT dhe të sigurohen fonde për ndërtimin dhe modernizimin e sistemeve, duke respektuar udhëzimet e AKSHI-t dhe duke u bazuar në praktikat më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare në këtë fushë.



Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Lezhë

Grupi i auditimit është mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, përkatësisht ISSAI 100 - Parimet themelore të auditimit në sektorin publik, ISSAI 5300 - Udhëzime për auditimin e IT-së dhe ISSAI 5310 - Metodologjia e Rishikimit të Sigurisë së Sistemit të Informacionit, si dhe në nenet 3 dhe 14 të Ligjit nr. 154, datë 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”. Nga auditimi i kryer është evidentuar se infrastruktura IT e Drejtorisë Rajonale Arsimore Parauniversitar Lezhë përballlet me problematika të rëndësishme që kërcënojnë sigurinë, si rrjedhojë e mungesës së një infrastrukture rrjeti të qëndrueshme, për shkak të mos implementimit të një fireëall-i dhe mungesës së mbrojtjes nga viruset, e cila kërcënon sigurinë dhe vazhdimësinë e shërbimeve të institucionit.

Po ashtu, mungesa e politikave të qarta për menaxhimin e aksesit dhe ndarjen e llogarive ndërmjet përdoruesve paraqet një rrezik serioz për integritetin dhe konfidencialitetin e të dhënave. Pa një sistem autentifikimi dhe autorizimi të qartë, gjurmimi i përgjegjësisë për veprimet e kryera në sistem bëhet i pamundur.

Përdorimi i fjalëkalimeve të dobëta dhe mungesa e një mekanizmi të menaxhimit të tyre e ekspozon institucionin ndaj sulmeve. Gjithashtu, ekspozimi fizik i pajisjeve IT pa masa mbrojtëse dhe mungesa e një qendre të menaxhimit të rrjetit riskojnë sigurinë dhe administrimin e infrastrukturës teknologjike.

UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS



Mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, përkatësisht ISSAI 100, ISSAI 5300 dhe ISSAI 5310, si dhe në nenet 3 dhe 14 të Ligjit nr. 154, datë 27.11.2014, "Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", dhe në analizën e evidencave dhe gjetjeve të auditimit të kryer, konstatohet se Universiteti i Sporteve të Tiranës nuk ka ndërmarrë masat e nevojshme për të siguruar një sistem të qëndrueshëm për menaxhimin e sigurisë së informacionit. Auditimi evidentoi mungesën e politikave të sigurisë së informacionit në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe aktet ligjore në fuqi, si dhe mungesën e mekanizmave të kontrollit për menaxhimin e aksesit të përdoruesve në infrastrukturën e teknologjisë së informacionit.

Gjithashtu, u evidentua përdorimi i pajisjeve me sisteme operative të papërditësuara, mungesa e masave të nevojshme të sigurisë teknike, si programe antivirus, si dhe përdorimi i pakontrolluar i pajisjeve të jashtme (USB), të cilat ekspozojnë institucionin ndaj rreziqeve të sigurisë.

Një tjetër mangësi përbën mungesa e një plani të formalizuar për vazhdimësinë e shërbimeve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, përfshirë masat për mbrojtjen nga humbja apo komprometimi i të dhënave administrative dhe akademike. Institucioni nuk ka përcaktuar strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe zbatimin e marrëveshjes kuadër me Rrjetin Akademik Shqiptar (RASH), çfarë përbën një risk në zbatimin e detyrimeve kontraktuale.


ZYRA RAJONALE STATISTIKORE FIER



Mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, përkatësisht ISSAI 100, ISSAI 5300 dhe ISSAI 5310, si dhe në nenet 3 dhe 14 të Ligjit nr. 154, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", auditimi evidentoi mungesë të praktikave të standardizuara për menaxhimin e infrastrukturës së TI dhe sigurisë së informacionit.

Mungesa e qendërimit në menaxhimin e infrastrukturës TI, përdorimi i llogarive me privilegje të plota dhe mungesa e udhëzimeve të qarta operationale, ekspozojnë Zyrën Statistike Fier ndaj rreziqeve të sigurisë së informacionit.

Zyra Rajonale Statistike Fier nuk është përdorues i sistemeve qendrore statistikore, çfarë krijon mundësi për gabime njerëzore në të dhënat statistikore që komunikohen në rrugë alternative.



QENDRA E STUDIMEVE DHE PUBLIKIMEVE PËR ARBËRESHËT

Mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAI 100, ISSAI 5300, ISSAI 5310) si dhe nenet 3 dhe 14 të Ligjit nr. 154/2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e KLSH”, auditimi konstaton se Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët nuk disponon sisteme të mirëstrukturuara të Teknologjisë së Informacionit. Infrastruktura aktuale mbështetet vetëm në një rrjet të kufizuar interneti, i cili nuk siguron funksionalitete për menaxhimin e sigurisë dhe performancës, duke mos përmbushur kërkesat minimale të standardeve ndërkombëtare për menaxhimin efektiv të TI-së.

Gjithashtu, Rregullorja e Brendshme e institucionit nuk përmban dispozita të qarta që rregullojnë sigurinë e informacionit dhe mbrojtjen e tij. Në përputhje me standardin ISO/IEC 27001 dhe praktikat më të mira, është e domosdoshme hartimi dhe zbatimi i politikave, procedurave dhe masave teknologjike për të garantuar mbrojtjen e informacionit dhe të aseteve të TI-së në institucion.



QENDRA KOMBËTARE TË KINEMATOGRAFISË

Mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit përkatësisht në, ISSAI 100, Parimet themelore të auditimit në sektorin publik, ISSAI 5300, Udhëzime për auditimin e IT-së, ISSAI 5310, Metodologjia e Rishikimit të Sigurisë së Sistemit të Informacionit, si dhe nenet 3 dhe 14 të ligjit nr. 154, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e KLSH”, bazuar në gjetjet e auditimit, evidencat e mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit për periudhën e aktivitetit nga data 01.01.2023 deri më datën 31.12.2024, vlerësojmë se mungesa e kontrolleve dhe mekanizmave të duhur me qëllim krijimin, mirëmbajtjen, zhvillimin e burimeve IT, si dhe mungesa e akteve rregullatore dhe mos delegimi i përgjegjësisë për veprimet e kryera në drejtim të sistemit të aplikimit online të projekteve që QKK ka investuar ndër vite, kanë ndikuar negativisht në zhvillimin dhe monitorimin efektiv të aktivitetit të institucionit.

Aktualisht QKK nuk ka ndërmarrë masa për të informatizuar procesin e aplikimeve online të projekteve duke qenë se sistemi që kanë përdorur është hequr nga përdorimi.

Gjithashtu, QKK nuk ka marrë masa në lidhje me marrjen e bazës së të dhënave nga Operatori Ekonomik, që është gjeneruar ndër vite për aq kohë sa është përdorur që nga implementimi i sistemit i cili ka gjeneruar këtë bazë të dhënash. Hapat e ndërmarrë në drejtim të rritjes së përdorimit, përmirësimit dhe sigurisë së shërbimeve që ofrohen nëpërmjet teknologjisë së informacionit janë të pamjaftueshëm, duke cënuar procesin e sigurisë së të dhënave dhe vazhdimësisë së ofrimit të shërbimeve pa ndërprerje.



AGJENCIA E ADMINISTRIMIT TË PASURIVE TË SEKUESTRUARA

Mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, përkatësisht ISSAI 100, ISSAI 5300 dhe ISSAI 5310, Manualin e Auditimit IT, si dhe në nenet 3 dhe 14 të Ligjit nr. 154, datë 27.11.2014, "Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", auditimi evidentoi mangësi në dokumentacionin rregullator dhe teknik, në strukturën e dedikuar për menaxhimin e IT-së, si dhe mbështetja e kufizuar teknike, të cilat krijojnë rreziqe për qëndrueshmërinë e proceseve në institucion.

Përdorimi i pajisjeve kompjuterike me akses të plotë administrativ, mungesa e antiviruseve, dhe dokumentimi i paplotë i aseteve TIK paraqesin rreziqe për sigurinë dhe kontrollin e informacionit.

Për shkak të problemeve të vazhdueshme funksionale në sistemin elektronik të regjistrimit të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara, punonjësit kanë përdorur Excel si mjet alternativ, për të vijuar me veprimet operacionale që kanë të bëjnë me administrimin e pasurive. Për këto të dhëna mungon një kopje rezervë periodike për të dhënat që gjenden lokalisht në çdo kompjuter, çfarë përbën një risk të disponibilitetit të të dhënave, vazhdimësinë operacionale dhe administrative të agjencisë.



GJYKATA E SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM SHKODËR

Mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, përkatësisht ISSAI 100, ISSAI 5300 dhe ISSAI 5310, Manualin e Auditimit IT, si dhe në nenet 3 dhe 14 të Ligjit nr. 154, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", vlerësojmë se mungesa e akteve rregullatorë në drejtim të sistemeve të teknologjisë së informacionit kanë ndikuar në zhvillimin e pa monitoruar të aktivitetit institucional dhe pa deleguar përgjegjësitë individuale për veprimet e kryera dhe të dhënave që gjenerohen nëpërmjet sistemit ICMIS (Sistemi i Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore).

Sistemi ICMIS i cili ka rëndësi të veçantë për sistemin e drejtësisë edhe pse ka pësuar ndryshime dhe zhvillime teknologjike ndër vite, si në shtim funksionaliteti, role dhe zhvillime të reja, janë shfaqur një sërë problematikash të cilat vështirësojnë ndjeshëm punën e përdoruesve me sistemin, saktësinë dhe përmbajtjen e informacionit që regjistrohet, aksesueshmërinë e tyre e si rrjedhojë përdorueshmërinë e informacionit nga strukturat e tjera ku Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër raporton.

Gjithashtu, infrastruktura qendrore e teknologjisë së informacionit në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër nuk është në përputhje me udhëzimet, standardet dhe praktikat më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare.


KOLEGJI I MBROJTJES DHE SIGURISË



Mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit përkatësisht në, ISSAI 100, Parimet themelore të auditimit në sektorin publik, ISSAI 5300, Udhëzime për auditimin e IT-së, ISSAI 5310, Metodologjia e Rishikimit të Sigurisë së Sistemit të Informacionit, si dhe nenet 3 dhe 14 të ligjit nr. 154, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH”, si dhe “Bazuar në procedurat e kryera dhe evidencat e mbledhura gjatë auditimit të Kontrolleve Bazë të Teknologjisë së Informacionit, ne konkludojmë se kontrollet IT të institucionit funksionojnë në mënyrë të pranueshme dhe ofrojnë një nivel të mjaftueshëm sigurie për mbrojtjen e të dhënave dhe funksionimin e sistemeve kritike.

Gjatë auditimit u identifikuan disa dobësi me ndikim mesatar, që lidhen kryesisht me menaxhimin e aksesit, kushtet e infrastrukturës së TI dhe dokumentimin e procedurave.

Në përgjithësi, mjedisi IT është i kontrolluar mirë dhe në përputhje me politikat dhe standardet përkatëse, por rekomandojmë adresimin e gjetjeve të shënuara për të rritur më tej nivelin e sigurisë dhe efektivitetin operacional.”



AGJENCIA E KOMBËTARE E DIASPORËS

Mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit përkatësisht në, ISSAI 100, Parimet themelore të auditimit në sektorin publik, ISSAI 5300, Udhëzime për auditimin e IT-së, ISSAI 5310, Metodologjia e Rishikimit të Sigurisë së Sistemit të Informacionit, si dhe nenet 3 dhe 14 të ligjit nr. 154, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH”, si dhe bazuar në procedurat e kryera dhe evidencat e mbledhura gjatë auditimit të Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit, rezulton se institucioni është pjesë përbërëse e rrjetit qeveritar e-Gov dhe kontrollet IT zbatohen në nivel qendror nga struktura e AKSHI-t dedikuar për Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme.

Gjatë auditimit u identifikuan disa dobësi si rrjedhojë e ndryshimeve ligjore dhe nënligjore në vitet e fundit që kanë të bëjnë me mungesën e strukturës organizative, mungesën e përmirësimit të rregullores së brendshme si dhe dokumentacionit teknik të sistemit që Agjencia administron në zbatim të VKM nr. 504, datë 24.6.2020 “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të studentëve të cilët studiojnë jashtë vendit, dhe shtetasve të huaj me origjinë shqiptare, të cilët përfitojnë bursa nga Republika e Shqipërisë”.


Gjithashtu, auditimi i sistemit informatik dhe bazës së të dhënave shtetërore që administron Agjencia, konstatoi se është populluar vetëm me të dhënat e aktivitetit të MASR sipas VKM nr. 160, datë 19.2.2020, duke krijuar mbivendosje funksionesh mbi administrimin e të dhënave personale të studentëve që kanë përfituar bursa jashtë vendit.

4. NIVELI I PRANUESHMËRISË SË REKOMANDIMEVE

Gjatë vitit 2025, Kontrolli i Lartë i Shtetit ka rekomanduar 4994 masa, nga të cilat: 29 janë përmirësime/ndryshime ligjore, 3268 janë masa organizative, 722 masa me efekte negative për shkak të parregullsive dhe 975 masa disiplinore dhe administrative.

Nga total 4994 masat, janë pranuar 4967 ose 99% dhe nuk janë pranuar 27 masa. Niveli i pranueshmërisë sipas llojit të rekomandimit, rezulton si më poshtë:

Infografik nr. 10: Pranueshmëria e masave sipas llojit



* sipas nenit 15, shkronja j të ligjit nr. 154/2014, "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"

Shënim: Për subjektet që nuk kanë sjellë përgjigje brenda 20 ditëve sipas nenit 15, shkronja j të ligjit nr. 154/2014, "Për Organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", automatikisht statusi i rekomandimeve konsiderohet "i pranuar". Për subjektet, të cilat edhe pse kanë respektuar afatin 20 ditor në kthimin e përgjigjes, por në shkresë nuk shprehen mbi pranueshmërinë e masës, masa do të konsiderohet "e pranuar".

5. ZHVILLIMI & MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE

5.1 STRUKTURA DHE ORGANIKA


Për vitin 2025, KLSH ka vijuar të adresojë menaxhimin e burimeve njerëzore në linjë me objektivat e përcaktuara në Dokumentin e Politikave të Burimeve Njerëzore dhe në funksion të realizimit të mbulimit me auditim sipas detyrimeve ligjore. Në fund të periudhës raportuese, numri faktik i punonjësve është 215 punonjës, nga të cilët 154 janë staf auditues (ose rreth 71.6% e numrit total të punonjësve) të përbërë nga:

- 11 kryeauditues
- 35 auditues të lartë
- 81 auditues të parë
- 27 auditues të dytë

Gjatë vitit 2025, në KLSH:

- janë rekrutuar 24 punonjës të rinj sipas procedurave të ligjit të nëpunësit civil dhe 8 punonjës referuar përcaktimeve të Kodit të Punës; si dhe
- janë ndërprerë marrëdhëniet administrative me KLSH-në, për 21 punonjës si rezultat i dorëheqje, pension pleqërie, largim nga SHC, masë disiplinore, zgjidhje kontrate, etj.

Infografik nr. 11: Organizimi i Burimeve Njerëzore




5.2 ZHVILLIMI I VAZHDUESHËM PROFESIONAL

Gjatë vitit 2025, u realizuan 137 tema trajnimesh, nga të cilat 29 të organizuara nga ASPA; 55 nga KLSH; 6 nga partnerë lokalë dhe 47 nga partnerët ndërkombëtarë si EUROSAL, IDI, CEF, SAI-e homologe, etj.

U trajnuan gjithsej 153 staf auditues, duke realizuar mesatarisht 27.5 ditë trajnimi/staf auditues për periudhën Janar - Dhjetor (nga mesatarisht 20 - 25 ditë trajnimi që është objektivi vjetor).

Ndërsa janë realizuar 21.3 ditë ditë trajnimi për stafin jo-auditues, (nga minimum 14 ditë që është objektivi vjetor).


Gjatë kësaj periudhe rreth 25% e trajnimeve u realizuan në sallë, me prezencë fizike, ndërsa 75% e tyre on-line.



Ndër temat kryesore, objekt trajnimi gjatë vitit 2025, rendisim çështje që lidhen me:

- Elementet e menaxhimit të marrëdhënies në shërbimin civil: legjislacioni dhe praktikat
- Integrimi Evropian
- Inteligjenca artificiale në sektorin publik: Mundësitë dhe sfidat
- KLSH trajnon për sistemin e Menaxhimit të Cilësisë, SoAQM
- Kodi Etik në KLSH
- Kuptueshmëria dhe mirëadministrimi i procedurave administrative
- Ligji për shërbimin civil
- Ligji i Prokurimit Publik për zbatimin e kontratave
- Manuali i Auditimit Financiar
- Manuali për rregullat e Etikës dhe Integriteti
- Menaxhimi dhe vlerësimi i projekteve
- Menaxhimi i riskut
- Objektivat e zhvillimit të qendrueshëm
- Përdorimi i të dhënave analitike dhe teknologjisë në auditim
- Përdorimi i teknologjisë në komunikim
- Prokurimet publike
- Rregullore e procedurave të auditimit
- Trajnim mbi Metodologjinë e punës për auditimin e koncesioneve në kuadër të projektit SECO

Infografik nr. 12: Ditët e trajnimeve për stafin auditues dhe jo-auditues, për vitin 2025



*Objektivat vjetore për realizimin e diteve të trajnimit për stafin auditues dhe jo-auditues për vitin 2025, janë miratuar me Vendimin e Kryetarit nr. 18, datë 21.01.2025 "Për miratimin e Programit të Zhvillimit të Integruar Profesional të Stafit të KLSH-së, për vitin 2025".


6. PROGRAMI I TRANSPARENCËS DHE E DREJTA PËR INFORMIM

Kontrolli i Lartë i Shtetit vijon të shqyrtojë me korrektësi dhe profesionalizëm të gjitha ankesat, denoncimet dhe kërkesat për informacion të ardhura nga qytetarët dhe media të ndryshme. Konkretisht, gjatë periudhës janar - dhjetor 2025, ka administruar 200 letra nga qytetarët dhe palët e ndryshme të interesit në formën e ankesave, kërkesave për informacion apo denoncimeve. Numri më i madh i këtyre ankesave ka marrë një përgjigje brenda afateve kohore të përcaktuara në ligj. Një pjesë e tyre mbeten në proces verifikimi në auditime të radhës sipas tematikave përkatëse, në përfundim të të cilave KLSH informon menjëherë qytetarin.

Ndërkohë, ankesa të vlerësuara jashtë fushës së kompetencave të KLSH-së, i janë dërguar për kompetencë institucioneve përgjegjëse ose është orientuar qytetari nëpërmjet përgjigjeve zyrtare se cilit institucion duhet t'i drejtohet, për të marrë përgjigje lidhur me problematikën që trajton.

Gjithashtu, në bazë të ligjit Nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, Kontrolli i Lartë i Shtetit gjatë periudhës janar - dhjetor 2025, ka trajtuar 11 kërkesa për informacion të ardhura nga qytetarë dhe përfaqësues të medias si dhe 189 ankesa apo denoncime nga qytetarë. Këto kërkesa kanë qenë kryesisht kërkesa mbi vënien në dispozicion të raporteve të ndryshme të auditimit të kryera nga KLSH dhe janë përcjellë tek kërkuesi brenda afateve ligjore të përcaktuara.

Infografik nr. 13: Nr i ankesave, denoncimeve dhe kërkesave administruar në KLSH
Janar - Dhjetor 2025



7. KLSH NË MEDIA

Auditimet të ndryshme kanë vijuar të trajtohen në media edhe përgjatë vitit 2025.

Gjatë vitit 2025, veprimtaria e KLSH-së është pasqyruar në media me një total prej 1115 artikujsh. 96 artikuj në shtypin e shkruar, 914 artikuj në median audio-vizive dhe online dhe 105 kronika dhe emisione televizive që pasqyrojnë gjetjet e raporteve përfundimtare të auditimit dhe rekomandimet e lëna për subjektet e audituara.

Ndër auditimet me më shumë impakt në media gjatë këtij viti kanë qenë:

- Auditimi mbi “Masat e ndërmarra nga institucionet përgjegjëse për eliminimin e derdhjes së ujërave të përdorura në Lumin e Lanës në Tiranë” .
- Auditimi “Shërbimi Psiko-Social në Sistemin Arsimor Parauniversitar”.
- Auditimi tematik “Mbi disponibilitetin e barnave për trajtimin e sëmundjeve tumorale”.
- Auditimi i performancës “Cilësia dhe certifikimi i ujit të pijshëm që hidhet në treg për qytetarin”.
- Auditimi “Ndotja në Liqenin Artificial të Tiranës”.
- Auditimi “Siguria kibernetike në infrastrukturën kritike E-Taxation”.
- Auditimi tematik “Mbi monitorimin e HEC Sasaj”.
- Auditimi i ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve.
- Auditimi në Drejtorinë e Përgjithshme të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor dhe Drejtorinë e Shërbimit Spitalor Universitar.
- Auditimi “Politikat dhe respektimi i të drejtave të personave me probleme të shëndetit mendor në shërbimin spitalor psikiatrik”.
- Auditimi “Orientimi për Karrierë i të Rinjve në Sistemin Arsimor Parauniversitar”.
- Auditimi “Mbrojtja e vlerave dhe pasurisë së vendit tonë në UNESCO”.

Në auditimet e pasqyruara nga media në vijimësi janë trajtuar gjetjet e raporteve për çështje me ndjeshmëri të lartë publike, si: disponibiliteti i banrave në trajtimin e sëmundjeve tumorale, mungesa e barnave të rimbursueshme, auditimi në HEC Sasaj Sarandë pas çarjes së digës së hidrocentralit, cilësia e ujit të pijshëm, ndotja në Liqenin Artificial të Tiranës dhe në lumin e Lanës, shërbimi psiko-social në shkollat e arsimit parauniversitar, siguria në shkolla, etj.

Institucionet përgjegjëse nuk kanë marrë masa efektive për përmirësimin e cilësisë së ujit në lumin Lana. Raportet e Gjendjes në Mjedis të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit konstatojnë prej vitesh se statusi i cilësisë së ujit në këtë trup uhor klasifikohet në gjendje shumë të ndotur, duke shfaqur përkeqësim edhe në fillim të rrjedhës në Lanabregas përgjatë viteve të fundit.

Një pjesë e shkollave, kryesisht në zonat rurale, nuk mbulohen me shërbim psiko-social. Kabinetet dhe mjetet ndihmëse mungojnë, por, dhe kur ato gjenden, në pjesën më të madhe të rasteve nuk janë të dedikuara për specialistët e këtij shërbimi. Ofrimi i shërbimit psiko-social për fëmijët me aftësi të kufizuara nuk kryhet sipas parashikimeve. Dokumentet strategjike në fuqi paraqesin në formë të fragmentuar objektiva për shërbimin psiko-social të cilat shpeshherë janë të mbivendosura.

7. KLSH NË MEDIA

KLSH ka ushtruar auditimin tematik “Mbi disponibilitetin e barnave për trajtimin e sëmundjeve tumorale”, i cili ka përfshirë Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS), Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” (QSUNT), Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH) dhe Agjencinë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore (AKBPM). Nga auditimi është evidentuar se nga institucionet e përfshira në auditim, nuk janë ezauruar në mënyrë të plotë veprimet e ndërmarra në kuadër të sigurimit të disponibilitetit të barnave të përdorura në trajtimin e sëmundjeve tumorale, veçanërisht në kuadër të mekanizmave të kontrollit dhe mbikëqyrjes si dhe bashkëpunimit ndërinstitucional.

KLSH ka realizuar auditimin e performancës me temë “Cilësia dhe certifikimi i ujit të pijshëm që hidhet në treg për qytetarin”, i cili është ushtruar për periudhën data 01.01.2020 deri më 31.12.2024. Auditimi “Cilësia dhe certifikimi i ujit të pijshëm që hidhet në treg për qytetarin” kishte si objektiv kryesor vlerësimin e veprimtarive të institucioneve përgjegjëse dhe efektivitetin e tyre, lidhur me garantimin e cilësisë së ujit që hidhet në treg për qytetarin.

Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH), kreu auditimin tematik të përputhshmërisë në Bashkinë Tiranë, institucionet e saj të varësisë dhe në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit (AKM), mbi ndotjen e Liqenit Artificial të Tiranës. Ky auditim tematik u iniciua mbi shqetësimin publik për ndotjen e Liqenit Artificial të Tiranës, në të cilin janë zhvilluar disa alga me ngjyrë të gjelbër dhe të verdhë, duke mbuluar sipërfaqe të konsiderueshme dhe që emetojnë në ajër një aromë të pakëndshme dhe shqetësuese për qytetarët që frekuentojnë Parkun e Madh të Liqenit Artificial të Tiranës

Kontrolli i Lartë i Shtetit ushtroi auditimin e performancës me temë “Siguria kibernetike në infrastrukturën kritike ETaxation”. Auditimi ka pasur si objektiv kryesor vlerësimin dhe analizimin e masave të marra nga institucionet përgjegjëse, si: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT), Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike (AKSK) mbi funksionimin dhe sigurinë kibernetike të sistemit elektronik të tatimeve E-Taxation.

KLSH kreu auditimin tematik “Mbi monitorimin e HEC Sasaj, Sarandë”, i cili nisi menjëherë pas çarjes së digës së hidrocentralit të Bunecit. Nga auditimi janë konstatuar disa mangësi, si: mungesa e monitorimeve nga ana e AKBN-së për HEC “Sasaj”, por dhe për HEC-e të tjerë; mos marrja e masave të vazhdueshme nga ana e koncesionarit për sigurinë e veprave përbërëse të HEC “Sasaj” dhe parandalimin e ngjarjeve të tilla. Nga auditimi u konstatua se koncesionari nuk ka realizuar punimet dhe nuk ka vënë në shfrytëzim HEC-in në kohën e parashikuar në marrëveshje. Po ashtu, koncesionari nuk ka zbatuar detyrimet kontraktore në lidhje me mirëmbajtjen dhe investimet periodike që duhet të kryeshin në veprat e HEC “Sasaj”.

7. KLSH NË MEDIA

Nga auditimi në Agjencinë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve për analizimin e ujit të pijshëm u konstatua se, nga 14 shoqëri ujësjellësish, 6 shoqëri (Berat, Elbasan, Korçë, Lushnjë, Pogradec dhe Sarandë) kanë ambiente për laborator, ndërsa 8 shoqëritë e tjera nuk kanë ambiente të përshtatshme për ndërtimin e laboratorëve, ose e thënë ndryshe nuk ka laboratorë, çka sjell mos kryerjen e analizave të ujit të pijshëm dhe mos garantimin e sigurisë tek qytetarët.


Impakt në media ka pasur edhe çështja e trajtimit të personave me probleme të shëndetit mendor në spitalet psikiatrike. Nga auditimi kryer në spitalet publike psikiatrike në Tiranë, Elbasan, Vlorë dhe Shkodër ka rezultuar mbipopullim i dhomave me pacientë me diagnoza të ndryshme, mungesë infrastrukture dhe stafi mjekësor etj.

Gjatë vitit 2025, në media është trajtuar edhe tema e raportit të auditimit të performancës “Orientimi për Karrierë i të Rinjve në sistemin arsimor parauniversitar”. Nga ky auditim u vlerësua se procesi i orientimit për karrierë i nxënësve nga institucionet përgjegjëse të sistemit të arsimit parauniversitar nuk ka rezultuar efektiv, si pasojë veçanërisht e mungesës së strukturave të dedikuara në institucionet përgjegjëse.

Auditimi i performancës “Mbrotja e vlerave dhe pasurisë së vendit tonë në UNESCO”, i cili nxori në pah disa problematika që lidhen me vëmendjen ndaj trashëgimisë kulturore, ka pasur vëmendje mediatike. Përmes këtij auditimit, KLSH evidentoi se Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit nuk merr asnjë masë konkrete për të adresuar zbatimin e rekomandimeve që lënë misionet e UNESCO-s për pasuritë pjesë e Listës së Trashëgimisë Botërore.




Top Channel/ Skandali te Onkologjiku /Raporti i KLSH, si ndryshojte data e skadencës së ilaçeve




Shkarkimi i ujërave të ndotura në Lanë. Raporti i KLSH: Institucionet kanë deshtuar!

Raporti i KLSH: Liqeni Artificial i Tiranës i sëmurë nga ndotja, institucionet nuk vepruan

Një inspektim i KLSH-së mbi gjendjen në Liqenin Artificial të Tiranës gjeti nivele ndotje të larta. KLSH thotë se institucionet përgjegjëse nuk kanë vepruar, ndërsa vë në dukje se mbi 10 milion lekë të shpenzuara u përdorën vetëm për pastrim mekanik dhe nuk trajtohen ndotjen nga cilësitë e ujit.



7. KLSH NË MEDIA



...në brigjet e detit, përmes kërkimit të shkencave të natyrës dhe të mjeteve të reja të komunikimit...



HC Asnjë masë për zbatimin e rekomandimeve të UNESCO për trashëgiminë kulturore

Auditimi/ Baseni i HEC Sasaj u shemb pasi nuk u mirëmbajt nga koncesionari! KLSH kërkon dëmshpërblimin e familjeve të përmbytura dhe shkarkimin e drejtorit të AKBN-së



1 Korrik, 10:34 | Postuar nga: 1 Korrik, 10:34

Kontrolli i Lartë i Shtetit ka kërkuar shkarkimin e drejtorit të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore për mos monitorim të hidrocentraleve. Duke marrë shkas nga përmbytjet e shkaktuara në janar nga HEC-i Sasaj në Lukovë, KLSH thekë se ky kontrakt nuk u monitorua, ndërkohë që shembja e basenit u...

KLSH gjen fajtorin, përmbytja në Bunec u shkaktua nga mosmirëmbajtja e HEC Sasaj

Nga: Vito Dine
7 Korrik 2021, 10:59 | Ekonomik



Nga: Bledi, Ekonomik, Financa, Kultura, Shtet, Regjori, Video, Raporti, Monitor Top List



SYRI TV/Skandali, qeveria nuk kontrollon cilësinë e ujit të pijshëm, shqiptarët të rrezikuar



8. Aneke

Tabela 1: Misionet e auditimit në numër, sipas llojit

Lloji i auditimit	Nr. Auditimesh	Pesha në %
IT	10	5%
Përputhshmërie	44	23%
Tematik	13	7%
Zbatim rekomandimesh	15	8%
Financiar dhe Përputhshmërie	32	17%
Performance	13	7%
Financiar	63	33%
Total auditime	190	100%

Tabela 1.1: Misionet e auditimit në numër, sipas departamenteve

Departamenti	Nr . Auditimesh
Departamenti i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit	13
Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Shtetit	46
Departamenti i Auditimit të Inst. të Sigurisë Shoqërive Publike & Investimeve të Huaja	37
Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore dhe Pronës Publike	76
Departamenti i Auditimit të Performancës	18
Total	190

Tabela 1.2: Auditimet/temat e auditimit specifike, sipas çdo departamentit të auditimit

Nr.	Subjekti/Tema
	Departamenti i Auditimit të Institucioneve të Sigurisë, Shoqërive Publike & Investimeve të Huaja
1	“Përmirësimi i sigurisë së digës në hidrocentralin e Komanit”, në KESH
2	Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes
3	Agjencia e Mbikëqyrjes Policore
4	Agjencia Kombëtare e Ujësllës Kanalizimeve
5	Agjencia Kombëtare e Ujësllës Kanalizimeve për Programin Kombëtar të Modernizimit të Sektorit të Ujësllës-Kanalizimeve në Shqipëri
6	AlbaFilm SHA
7	Auditim tematik "Për verifikimin e shkaqeve, pasojave dhe reagimit të institucioneve, lidhur me situatën e krijuar nga përmytjet masive në qytetin e Vlorës", për një periudhë të pacaktuar
8	Autoriteti i Aviacionit Civil
9	Autoriteti Kombëtar i Ushqimit
10	Autoriteti Portual Durrës
11	Drejtorja e Përgjithshme Detare Durrës
12	Drejtorja e Ujitjes dhe Kullimit Fier
13	Drejtorja e Ujitjes dhe Kullimit Korçë
14	Drejtorja e Ujitjes dhe Kullimit Lezhë
15	Drejtorja Vendore të Policisë Shkodër
16	Enti Kombëtar i Banesave
17	Fuqia energjitike dhe siguria e digës në kaskadën e Drinit”, në KESH
18	Mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH në subjektin “Albgaz” SHA.
19	Mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH në subjektin “Shoqëria Rajonale Ujësllës Kanalizime Vlorë” SHA.
20	Mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH në subjektin “Universiteti i Mjekësisë”
21	Operatori i Shpërndarjes të Energjisë Elektrike
22	Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, Drejtorja Rajonale Durrës
23	Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, Drejtorja Rajonale Shkodër
24	Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, Drejtorja Rajonale Tiranë
25	Projekti: “Infrastruktura Bashkiake V”
26	Rezidenca Studentore Universitare Nr. 2, SHA
27	Shoqëria Rajonale e Ujësllës Kanalizime, Lezhë SHA
28	Shoqëria Rajonale Ujësllës Kanalizime, Elbasan SHA
29	Spitali Rajonal Shkodër
30	Spitali Rajonal Vlorë
31	Termocentrali i Vlorës SHA
32	Trajtimi i Studentëve Elbasan SHA
33	Trajtimi i Studentëve Gjirokastër SHA
34	Trajtimi i Studentëve Korçë SHA
35	Trajtimi i Studentëve Shkodër SHA
36	Trajtimi i Studentëve Vlorë SHA
37	Zbatimi i rekomandimeve të auditimeve, (6 mujori I-II)
	Departamenti i Auditimit IT
38	Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara
39	Agjencia Kombëtare e Diasporës
40	Drejtorja Rajonale të Arsimit Parauniversitar Lezhë
41	Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër
42	Kolegji i Mbrojtjes dhe Sigurisë
43	Qendra e Arsimit Bashkia Lushnje
44	Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët
45	Qendra Kombëtare e Kinematografisë
46	Siguria kibernetike në infrastrukturën kritike e-Taxation
47	Universiteti i Sporteve të Tiranës

Nr.	Subjekti/Tema
48	Zbatimi i Rekomandimeve të auditimeve, (6 mujori I) – IT
49	Zbatimi i rekomandimeve të auditimeve, (6 mujori II) – IT
50	Zyra Rajonale Statistike Fier
Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Shtetit	
51	“Mbi auditimin e procedurave të dhënies së lejeve, licencave dhe monitorimin e aktivitetit minerar me vendndodhje në Rasek, Shkodër”.
52	“Përmirësimi i aksesit të barabartë në shërbimet publike të standardit të lartë nëpërmjet operacionit Govtech”
53	Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive
54	Agjencia Kombëtare e Bregdetit
55	Zbatimi i Rekomandimeve të auditimeve të kryera në institucionet qendrore (6 mujori I)
56	Auditim tematik në Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve mbi çështjet e trajtuara në ankesën e federatës shqiptare "Kick Boxing"
57	Zbatimi i Rekomandimeve të auditimeve (6 mujori I)
58	Autoriteti për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit
59	Avokati i Popullit
60	Avokatura e Shtetit
61	Cirku i Tiranës
62	Dega Doganore Durrës
63	Dega Doganore Rinas
64	Disponibiliteti i barnave në trajtimin e sëmundjeve tumorale
65	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (pjesa I)
66	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (pjesa II)
67	Drejtoria e Përgjithshme e Pronës Publike
68	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
69	Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës
70	Drejtoria Rajonale Tatimore Elbasan
71	Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor
72	Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë
73	Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm
74	Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave
75	Instituti i Sigurimeve Shoqërore
76	Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë
77	Kolegji i Posaçëm i Apelit
78	Korporata e Investimeve Shqiptare
79	Mbi ecurinë, performancën dhe efektivitetin e masave të marra në lidhje me borxhin doganor
80	Mbi ofrimin e shërbimit të ushqimit në Spitalin Rajonal Korçë
81	Mbi përputhshmërinë e monitorimit të HEC “Sasaj” Sarandë
82	Mbi përputhshmërinë në ofrimin e shërbimit rezidencial dhe procedurat për birësimin e të miturve
83	Mbi vlerësimin e ecurisë, performancës dhe efektivitetit të masave të marra në lidhje me borxhin tatimor
84	Ministria e Arsimit dhe Sportit
85	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
86	Ministria e Financave (Aparati)
87	Ministria e Financave mbi Zbatimin e Buxhetit
88	Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
89	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
90	Qendrën Burimore “Ramazan Kabashi”
91	Rektorati (Universiteti i Tiranës)
92	Shkolla e Magjistraturës
93	Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkodër
94	Universiteti i Tiranës : Fakulteti i Ekonomisë
95	Universiteti i Tiranës : Fakulteti i Gjuhëve të Huaja
96	Zbatimi i Rekomandimeve të auditimeve, (6 mujori I)

Nr.	Subjekti/Tema
	Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore dhe Pronës Publike
97	“Mbi verifikimin e situatës pas rrëshqitjeve në rrugën Matogjin - Bashaj”
98	Agjencia Shtetërore për Shpronësim Tiranë
99	Bashkia Belsh
100	Bashkia Berat
101	Auditim i pasqyrave financiare, Bashkia Berat
102	Bashkia Bulqizë
103	Bashkia Cërrik
104	Bashkia Delvinë
105	Bashkia Devoll
106	Bashkia Dibër
107	Bashkia Dimal
108	Auditim i pasqyrave financiare, Bashkia Dimal
109	Bashkia Divjakë
110	Bashkia Dropull
111	Bashkia Durrës
112	Bashkia Elbasan
113	Auditim i pasqyrave financiare, Bashkia Elbasan
114	Bashkia Fier
115	Auditim i pasqyrave financiare, Bashkia Fier
116	Bashkia Finiq
117	Bashkia Fushë Arrëz
118	Bashkia Gjirokastrë
119	Bashkia Gramsh
120	Bashkia Has
121	Bashkia Kamëz
122	Bashkia Kavajë
123	Bashkia Këlcyrë
124	Bashkia Klos
125	Bashkia Kolonjë
126	Bashkia Konispol
127	Bashkia Korçë
128	Auditim i pasqyrave financiare, Bashkia Korçë
129	Bashkia Krujë
130	Bashkia Kuçovë
131	Bashkia Kukës
132	Bashkia Kurbín
133	Bashkia Lezhë
134	Bashkia Libohovë
135	Bashkia Librazhd
136	Bashkia Lushnjë
137	Auditim i pasqyrave financiare, Bashkia Lushnjë
138	Bashkia Malësi e Madhe
139	Bashkia Maliq
140	Auditim i pasqyrave financiare, Bashkia Maliq
141	Bashkia Mallakastër
142	Bashkia Mat
143	Bashkia Memaliaj
144	Bashkia Mirditë
145	Bashkia Patos
146	Bashkia Përmet
147	Bashkia Pogradec
148	Bashkia Poliçan

Nr.	Subjekti/Tema
149	Bashkia Prrenjas
150	Bashkia Pukë
151	Bashkia Pustec
152	Bashkia Roskovec
153	Bashkia Rrogozhinë
154	Bashkia Sarandë
155	Auditim i pasqyrave financiare, Bashkia Sarandë
156	Bashkia Selenicë
157	Auditim i pasqyrave financiare, Bashkia Selenicë
158	Bashkia Shijak
159	Bashkia Shkodër
160	Bashkia Skrapar
161	Auditim i pasqyrave financiare, Bashkia Skrapar
162	Bashkia Tepelenë
163	Auditim i pasqyrave financiare, Bashkia Tropojë
164	Bashkia Tropojë
165	Bashkia Vau i Dejës
166	Bashkia Vlorë
167	Bashkia Vorë
168	Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit
169	Zbatimi i Rekomandimeve të auditimeve, (6 mujori I)
170	Verifikim i ankesës së banorëve të fshatit Piskovë në lidhje me vend depozitimin e mbetjeve urbane
171	Zbatimi i Rekomandimeve të auditimeve, (6 mujori II)
172	Zbatim Rekomandime të auditimeve për ASHK
Departamenti i Auditimit të Performancës	
173	Cilësia dhe certifikimi i ujit të pijshëm që hidhet në treg për qytetarin
174	Kujdesi komunitar për të moshuarit dhe decentralizimi i shërbimit
175	Planet gjithëpërfshirëse të qeverisë dhe aspektet buxhetore për një popullsi në moshim
176	Roli dhe përgjegjësitë për monitorimin e mirëqenies së fëmijëve të birësuar
177	Shërbimi psiko - social në sistemin arsimor parauniversitar
178	Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura Tiranë, në Administratën e Zonave të Mbrojtura AdZM Kukës, AdZM Berat dhe AdZM Vlorë
179	Aksesueshmëria për personat me aftësi të kufizuara
180	Blerjet online në Shqipëri, taksat dhe shërbimi ndaj qytetarit
181	Cilësia e ujërave në plazhe
182	Masat e ndërmarra nga institucionet përgjegjëse për eliminimin e derdhjes së ujërave të përdorura në Lumin e Lanës në Tiranë
183	Mbrojtja dhe Siguria e Digave
184	Ndikimi në mjedis dhe shëndet i aktivitetit të shfrytëzimit të naftës dhe gazit në zonën Patos - Marinëz
185	Ndotja e Liqenit Artificial të Tiranës
186	Roli dhe efektiviteti i oficerëve të sigurisë në shkolla
187	Trajtimi, rehabilitimi dhe ri-integrimi i personave të dënuar
188	Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë, në institucionet e mjedisit, evaduar në vitin 2023
189	Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e performancës (6 mujori II)
190	Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e performancës (6 mujori I)

Tabela nr.2: Opinionet/mesazhet/konkluzionet sipas llojit të auditimit

Lloji i auditimit	Lloji i opinionit				Total
	I modifikuar	I pamodifikuar	Konkluzione	Mesazh	
Financiar	48	15	-	-	63
I kombinuar nga të cilët:					
-Financiar	25	7	-	-	32
-Përputhshmërie	29	3	-	-	32
IT	-	-	10	-	10
Performance	-	-	1	13	14
Përputhshmërie	39	-	5	-	44
Tematik	-	-	12	-	12
Zbatim rekomandimesh	-	-	15	-	15
Total	141	25	43	13	222

Tabela 2.1 : Kualifikimi i opinioneve sipas llojit të auditimit

Lloji i auditimit	Financiar, i pakualifikuar me theksim të çështjes	I kualifikuar	I kundërt	I pakualifikuar	Konkluzion	Me rezervë	Mesazh	Total
Financiar	11	41	2	4		5		63
I kombinuar	4	50	1	6		3		64
IT					10			10
Performance							13	13
Përputhshmërie		39			5			44
Tematik					13			13
Zbatim rekomandimesh					15			15
Total	15	130	3	10	43	8	13	222

Tabela 2.2: Kualifikimi i opinioneve sipas subjekteve

Lloji i auditimit	Financiar, i pakualifikuar me theksim të çështjes	I kualifikuar	I kundërt	I pakualifikuar	Konkluzion	Me rezervë	Mesazh	Total
Financiar								
“Përmirësimi i aksesit të barabartë në shërbimet publike të standardit të lartë nëpërmjet operacionit Govtech”				1				1
Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes	1							1
Agjencia e Mbikëqyrjes Policore		1						1

Lloji i auditimit	Financiar, i pakualifikuar me theksim të çështjes	I kualifikuar	I kundërt	I pakualifikuar	Konkluzion	Me rezervë	Mesazh	Total
Agjencia Kombëtare e Ujësjetllës Kanalizimeve për Programin Kombëtar të Modernizimit të Sektorit të Ujësjetllës-Kanalizimeve në Shqipëri	1							1
AlbaFilm SHA	1							1
Bashkia Berat (auditim Financiar)			1					1
Bashkia Bulqizë		1						1
Bashkia Cërrik		1						1
Bashkia Delvinë	1							1
Bashkia Devoll		1						1
Bashkia Dimal (auditim Financiar)						1		1
Bashkia Divjakë		1						1
Bashkia Durrës		1						1
Bashkia Elbasan (Financiar)		1						1
Bashkia Fier (Financiar)						1		1
Bashkia Finiq		1						1
Bashkia Fushë Arrëz	1							1
Bashkia Has		1						1
Bashkia Kamëz	1							1
Bashkia Kavajë		1						1
Bashkia Këlcyrë		1						1
Bashkia Klos		1						1
Bashkia Korçë (Auditim financiar)		1						1
Bashkia Krujë		1						1
Bashkia Kukës		1						1
Bashkia Kurbin		1						1
Bashkia Lezhë				1				1
Bashkia Libohovë		1						1
Bashkia Lushnje (auditim Financiar)						1		1
Bashkia Malësi e Madhe		1						1
Bashkia Maliq		1						1
Bashkia Maliq (Financiar)		1						1
Bashkia Mat		1						1
Bashkia Memaliaj		1						1
Bashkia Mirditë		1						1
Bashkia Patos		1						1
Bashkia Pogradec		1						1
Bashkia Poliçan		1						1
Bashkia Prrenjas		1						1
Bashkia Pukë		1						1
Bashkia Pustec		1						1
Bashkia Roskovec		1						1
Bashkia Rrogozhine		1						1

Lloji i auditimit	Financiar, i pakualifikuar me theksim të çështjes	I kualifikuar	I kundërt	I pakualifikuar	Konkluzion	Me rezervë	Mesazh	Total
Bashkia Sarandë (Auditim Financiar)		1						1
Bashkia Selenicë (Financiar)		1						1
Bashkia Shijak		1						1
Bashkia Shkodër		1						1
Bashkia Skrapar (auditim Financiar)		1						1
Bashkia Tepelenë		1						1
Bashkia Tropojë		1						1
Bashkia Vau i Dejës			1					1
Bashkia Vorë	1							1
Drejtoria e Përgjithshme Detare Durrës	1							1
Enti Kombëtar i Banesave		1						1
Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë	1							1
Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm	1							1
Kolegji i Posaçëm i Apelimit	1							1
Rektorati (Universiteti i Tiranës)				1				1
Trajtimi i Studentëve Elbasan SHA						1		1
Trajtimi i Studentëve Gjirokastrë SHA		1						1
Trajtimi i Studentëve Korçë SHA		1						1
Trajtimi i Studentëve Shkodër SHA						1		1
Trajtimi i Studentëve Vlorë SHA				1				1
Financiar Total	11	41	2	4		5		63
I kombinuar								
Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive		1						1
Avokati i Popullit		1						1
Bashkia Belsh		1						1
Bashkia Dibër		1						1
Bashkia Dropull	1							1
Bashkia Elbasan		1						1
Bashkia Fier						1		1
Bashkia Gjirokastrë		1						1
Bashkia Gramsh		1						1
Bashkia Kolonjë		1						1
Bashkia Konispol						1		1
Bashkia Korçë		1						1
Bashkia Kuçovë		1						1
Bashkia Librazhd		1						1
Bashkia Lushnje		1						1
Bashkia Mallakastër		1						1
Bashkia Përmet		1						1
Bashkia Sarandë						1		1

Lloji i auditimit	Financiar, i pakualifikuar me theksim të çështjes	I kualifikuar	I kundërt	I pakualifikuar	Konkluzion	Me rezervë	Mesazh	Total
Bashkia Vlorë		1						1
Cirku i Tiranës		1						1
Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	1							1
Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor		1						1
Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave				1				1
Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit	1							1
Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë		1						1
Ministria e Financave (Aparati)			1					1
Shkolla e Magjistraturës				1				1
Shoqëria Rajonale e Ujësjetës Kanalizime Lezhë SHA	1							1
Shoqëria Rajonale Ujësjetës Kanalizime, Elbasan				1				1
Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkodër		1						1
Universiteti i Tiranës: Fakulteti i Gjuhëve të Huaja		1						1
Universiteti i Tiranës: Fakulteti i Ekonomisë		1						1
I kombinuar/Financiar Total	4	21	1	3		3		32
Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive		1						1
Avokati i Popullit		1						1
Bashkia Belsh		1						1
Bashkia Dibër		1						1
Bashkia Dropull		1						1
Bashkia Elbasan		1						1
Bashkia Fier		1						1
Bashkia Gjirokastrë		1						1
Bashkia Gramsh		1						1
Bashkia Kolonjë		1						1
Bashkia Konispol		1						1
Bashkia Korçë		1						1
Bashkia Kuçovë		1						1
Bashkia Librazhd		1						1
Bashkia Lushnje		1						1
Bashkia Mallakastër		1						1
Bashkia Përmet		1						1
Bashkia Sarandë		1						1
Bashkia Vlorë		1						1

Lloji i auditimit	Financiar, i pakualifikuar me theksim të çështjes	I kualifikuar	I kundërt	I pakualifikuar	Konkluzion	Me rezervë	Mesazh	Total
Cirku i Tiranës		1						1
Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve		1						1
Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor		1						1
Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave				1				1
Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit		1						1
Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë		1						1
Ministria e Financave (Aparati)		1						1
Shkolla e Magjistraturës		1						1
Shoqëria Rajonale e Ujësjiellës Kanalizime Lezhë SHA		1						1
Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime, Elbasan		1						1
Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkodër		1						1
Universiteti i Tiranës: Fakulteti i Gjuhëve të Huaja				1				1
Universiteti i Tiranës: Fakulteti i Ekonomisë				1				1
I kombinuar Total		29		3				32
IT								
Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara					1			1
Agjencia Kombëtare e Diasporës					1			1
Drejtoria Rajonale të Arsimit Parauniversitar Lezhë					1			1
Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër					1			1
Kolegji i Mbrojtjes dhe Sigurisë					1			1
Qendra e Arsimit Bashkia Lushnje					1			1
Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët					1			1
Qendra Kombëtare të Kinematografisë					1			1
Universiteti i Sporteve të Tiranës					1			1
Zyra Rajonale Statistike Fier					1			1
IT Total					10			10
Performancë								
“Kujdesi komunitar për të moshuarit dhe decentralizimi i shërbimit”							1	1
“Planet gjithëpërfshirëse të qeverisë dhe aspektet buxhetore për një popullsi në moshim”							1	1

Lloji i auditimit	Financiar, i pakualifikuar me theksim të çështjes	I kualifikuar	I kundërt	I pakualifikuar	Konkluzion	Me rezervë	Mesazh	Total
“Shërbimi psiko-social në sistemin arsimor parauniversitar”							1	1
Aksesueshmëria për personat me aftësi të kufizuara							1	1
Blerjet online në Shqipëri, taksat dhe shërbimi ndaj qytetarit							1	1
Cilësia dhe certifikimi i ujit të pijshëm që hidhet në treg për qytetarin							1	1
Cilësia e ujërave në plazhe							1	1
Masat e ndërmarra nga institucionet përgjegjëse për eliminimin e derdhjes së ujërave të përdorura në Lumin e Lanës në Tiranë							1	1
Mbrojtja dhe Siguria e Digave							1	1
Ndikimi në mjedis dhe shëndet i aktivitetit të shfrytëzimit të naftës dhe gazit në zonën Patos-Marinëz							1	1
Roli dhe efektiviteti i oficerëve të sigurisë në shkolla							1	1
Siguria kibernetike në infrastrukturën kritike e-Taxation							1	1
Trajtimi, rehabilitimi dhe ri-integrimi i personave të dënuar							1	1
Performancë Total							13	13
